

ANDROKLI KOSTALLARI

GJUHA E SOTME LETRARE SHQIPE DHE DISA PROBLEME THEMELORE TË DREJTSHKRIMIT TË SAJ

Në jetën e popullit tonë ka shumë ngjarje, të cilat, duke përqëndruar në vetvete përmbajtjen e epokave të tëra, qëndrojnë si gurë shënues të hapave që ky popull ka bërë përpara në histori. Një vend të veçantë ndër to zënë përpjekjet për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Këto përpjekje nuk kanë fillim e mbarim. Për ato flasin edhe krijimet gojore, edhe shkrimet shqipe të të gjitha kohëve. Kujdesi për fatet e gjuhës amtare është shfaqur me mënyra e veprime të ndryshme, por ai është ushqyer kurdoherë nga heroizmi i heshtur i masave të gjera, nga gjallëria e tyre e pandërprerë gjuhë-krijuese e gjuhëmbrojtëse dhe ka përshkuar shekujt si një shqetësim i thellë. Populli ynë e ka ndjerë gjuhën amtare kurdoherë si diçka të pandarë nga vetë qënja e tij, si një shok të vërtetë lufte. Me të ai ka shprehur personalitetin e tij etnik e shoqëror, mendimin, vullnetin e veprën e tij historike, gëzimin e dhimbjen, ëndërrat, dashurinë dhe urrejtjen. Prandaj as këngëtari a tregimtari popullor, as poeti, dijetari a veprimtari shoqëror nuk kanë mundur të flasin për gjuhën amtare me zemër të ftohtë e ta kundrojnë atë si objekt muzeu. Kjo ndihet e bie në sy menjëherë që nga Buzuku e Bogdani tek Kristoforidhi, Naimi, Samiu, Vretua, Pashko Vasa e De Rada, që nga Çajupi, Mjeda, Luigj Gurakuqi, Noli e Asdreni tek Migjeni e Xhuvani dhe deri tek letërsia e pasur e shumëdegëshe e ditëve tona. Kjo ndihet edhe tek shpresa e frymëzimi që kanë gjetur kurdoherë tek vargjet e këngës shqipe bijtë e këtij populli, që u hodhën nga valët e historisë përtej deteve e oqeanëve. «Ashtu siç qëndrojnë flamurët në betejë si simbol i Atdheut, që rreth tyre të mblidhen luftëtarët e përndarë, — thotë me ngashërim Gabriel Dara — po ashtu edhe këngët, ndër mote, janë drita ku ndizen zemrat e trimave, simboli i kombit, flamuri i nderit, testamenti i të parëvet»¹. Shumë gjëmadha ka lënë historia në jetën e popullit tonë. Qytete, kështjella e fshatra janë rrafshuar me tokën o janë mbuluar nën dhé, breza të tërë janë shuar, njerëzit shpeshherë kanë qenë të detyruar të braktisnin vatrën e të parëve, të ndryshonin veshjen, fenë e mënyrën e jetesës. Por,

1) Gabriel Dara, *Kënka e sprasme e Balës*, Catanzaro, 1906, f. 54: «...si fljamurat ndër ljuftën rrin për shënk i Ateris, sa t'i mblidhen rreth rreth ushtorët të shprishur, ashtu kënkat, ndër mën, jan drita tek celjen zhëmmerat e t'urtëvet, shenku i gjindes, fljamuri i nderies, dhiata e prindëvet.»

edhe në rastet më të skajshme, ka mbetur i pakëputur një fill që e ka ruajtur të gjallë lidhjen e breznive e të epokave, vetëdijen e kombësisë e të kombit. Ky fill është gjuha jonë amtare. Mund të themi me plot gojën se gjuha shqipe, e marrë në tërësinë e saj, jo vetëm si një *érgon* (vepër e përfunduar), por edhe si një *enérgeia* (veprimtari), në trajtën e folur dhe në atë të shkruar, është një enciklopedi e gjithë jetës së popullit tonë — më e vjetra e më e reja, më e plota e më e vërteta enciklopedi.

Duke u zhvilluar gjatë shekujve sipas nevojave e kërkesave të shoqërisë sonë, gjuha e shkruar shqipe, në lidhje të pandërprerë me gjuhën e folur popullore, ka arritur tashti të bëhet një gjuhë letrare kombëtare në kuptimin më të plotë të fjalës. Kjo është forma më e lartë në jetën e gjuhës sonë. Një nga kërkesat themelore e njëkohësisht një nga treguesit më të qartë të kësaj forme është edhe drejtshkrimi i njësuar, pjesa përbërëse më e dukshme e normës letrare kombëtare. Nuk është aspak e rastit që edhe në shekujt e kaluar, edhe në shekullin tonë problemet e formimit të gjuhës letrare shqipe janë shtruar në radhë të parë si probleme të alfabetit e të drejtshkrimit: procesin e kristalizimit të normës gjuhësore letrare e udhëheq kurdoherë gjuha e shkrimit. Por kjo fytyrë e jashtme e gjuhës pasqyron, në fund të fundit, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, procesin e thellë e të ndërlikuar të brendshëm të ngjizjes e të ngulitjes së strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore të gjuhës letrare kombëtare në të gjitha hallkat e saj më të rëndësishme. Prandaj njësimi i drejtshkrimit, si rrjedhim ligjësor i këtij procesi dhe si shfaqje e fazës së fundit të kristalizimit të normës letrare, parakupton dhe vulos njësimin strukturor të gjuhës letrare të përbashkët për gjithë popullin tonë. Njëkohësisht ai bëhet një fuqi vepruese që e lehtëson, e shpejton dhe e rrënjos më thellë këtë njësim, duke e ndihmuar gjuhën letrare kombëtare t'i kryejë më mirë funksionet e saj shoqërore. Pikërisht këtu qëndron rëndësia e tij themelore si në aspektin thjesht gjuhësor, ashtu edhe në atë kulturor e shoqëror.

Nga një kuptim i tillë ne vlerësojmë edhe rolin historik të këtij Kongresi të drejtshkrimit. Gjatë shumë shekujve, që nga libri i parë shqip, përpjekjet për të zgjidhur problemin e alfabetit e të drejtshkrimit të shqipes janë gërshetuar organikisht me lëvizjet e mëdha politiko-shoqërore e kulturore, në programin e të cilave lufta për mbrojtjen e lëvrimin e gjuhës amtare, për ta ngritur atë deri në shkallën e një gjuhe letrare të përbashkët zë një vend të dorës së parë. Kongresi ynë i drejtshkrimit është kurorëzimi i këtyre përpjekjeve, me pendë e me pushkë, në rrugën e gjatë, që është çelur me një punë të mundimshme e vetmohuese dhe me gjakun e shumë dëshmorëve. Po mbyllet një etapë shumëshekullore — etapa e ekzistencës së gjuhës sonë letrare në disa variante dialektore dhe po çelët etapa e zotërimit të plotë të një gjuhe të vetme letrare, me një normë të njësuar për gjithë popullin shqiptar. Dhe është kuptimplotë që kjo u arrit në epokën kur populli ynë po ndërton shoqërinë socialiste, nën udhëheqjen e Partisë.

Pa dyshim, në etapën e re, në të cilën po hyn gjuha jonë letrare,

zhvillimi i saj nuk do të ndalet. Përkundrazi, kjo gjuhë do të përsoset gjithnjë më shumë si në planin e përmbajtjes, ashtu edhe në atë të shprehjes. Në të do të pasqyrohen në mënyrë edhe më të shumanshme e më të thellë se deri më sot veçoritë e pasuritë shpirtërore të popullit shqiptar, rruga ngjithëse e dinamike jo vetëm e brezave të sotëm, por edhe e një vargani të tërë të brezave të ardhshëm, sepse, siç e thekson Lenini, «dallimet kombëtare midis popujve... do të mbeten akoma për një kohë shumë e shumë të gjatë, bile edhe pas fitores së diktaturës së proletariatit në shkallë botërore»².

I.

Drejtshkrimi nuk është një sistem i pavarur rregullash që qëndron në vetvete e për vetveten. Për të kuptuar thelbin e tipareve e të problemeve themelore të drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare të sotme, si edhe rolin e faktorëve gjuhësorë e shoqërorë që bënë të mundshëm njësimin e tij, është e nevojshme të njohim, qoftë edhe në vijat më të përgjithshme, veçoritë historike të formimit të gjuhës sonë letrare kombëtare dhe të normës së sotme letrare, të parë si një sistem në zhvillim, që ka jo vetëm të kaluarën e të sotmen, por edhe të ardhmen.

Zbërthimi dhe vlerësimi i drejtë i këtyre veçorive, që janë rrjedhim i një procesi të gjatë e të ndërlikuar, kushtëzohet, para së gjithash, nga baza teorike, metodologjike ku do të mbështetet analiza historike gjuhësore. Siç dihet, që nga rryma e idealizmit estetik të Foslerit e sidomos pas shpalljes së tezave të «Rrethit lingvistik të Pragës»³, gjuha letrare është bërë një nga problemet qendrore të gjuhësisë botërore, e në radhë të parë, të gjuhësisë funksionale. Në trajtimin dhe zgjidhjen ballësore të këtij problemi ose të anëve të tij të veçanta janë ndeshur e ndeshen edhe në kohën tonë koncepti materialist historik dhe koncepti idealist mbi gjuhën në përgjithësi e mbi gjuhët kombëtare e normën e tyre letrare, në mënyrë të veçantë. Në larminë e madhe të teorive gjuhësore borgjeze të shekullit tonë, ku vihen re teza e pikëpamje shpeshherë kontradiktore, mund të themi se bien në sy dy grupime kryesore, të cilat qëndrojnë në dy skajet e një vije të vetme idealiste. Më njërin anë, qëndrojnë teoritë që mbështeten në të ashtuquajturën «hipotezë të Sepir-Uorfit», të cilat i pranojnë lidhjet e gjuhës me shoqërinë, me veçoritë e popullit e të kombit, me kulturën e me proceset e njohjes, por i caktojnë gjuhës, ndër të tjera edhe gjuhës letrare, vendin drejtues në këto lidhje. Sipas tyre, jo gjuha varet nga shoqëria, por shoqëria dhe sjellja shoqërore e njeriut varen nga gjuha⁴. Koncepte të ngjashme mbron

2) V. I. Lenin, *Sëmundja foshnjore e «majtizmit», në komunizëm*, Veprat (bot. 4 rus.), vëll. 31, f. 72.

3) Shih Théses, «Travaux du Cercle linguistique de Prague», I, Prague, 1929.

4) Shih E. Sapir, *The status of linguistics as a science* «Language» vol. 5, 1929; E. Sapir, *The unconscious patterning of behavior in society*. «A symposium», Chicago, 1927; E. Sapir, *Language, An introduction to the study of speech*, Ottava, 1921; B. Uorf, *Raporti i normave të sjelljes dhe të mendimit me gjuhën*, bot. rus. në «Novoje v lingvistike», Moskë, 1960, v. 1.

edhe rryma neohumboldtiane, që përfaqësohet sidomos nga Ernst Kasireri, Jost Triri e Leo Vajsgerberi dhe që e ka thelluar më tej pikëpamjen e Vilhelm Humboldtit se «me të njëjtin akt, me të cilin njeriu krijon nga vetja gjuhën, ai e vë vetveten në duart e saj»⁵. Të dyja këto rryma i njohin gjuhës një fuqi vepruese imanente e konstruktive, pavarësisht nga zhvillimi historik i shoqërisë. Ato i kthejnë marrëdhënjet shoqëri-gjuhë me kokë poshtë. Duke e parë, kështu, çdo popull si një skllav të përjetshëm të gjuhës, këto teori i mohojnë atij mundësinë që të ndikojë sadopak mbi normat gjuhësore që krijon e zhvillon ai vetë gjatë historisë.

Në skajin tjetër të po kësaj vije qëndron një grupim edhe më i gjerë studjuesish që, në thelb, e trajtojnë gjuhën tërësisht ose kryesisht si fenomen që u nënshtrohet po atyre ligjeve sasiore, të cilave u nënshtrohen fenomenet fizike, kimike, biologjike e format e tjera të lëvizjes së materies. Vetvetiu një koncept i tillë, që lidhet zakonisht me filozofinë neopozitiviste e pragmatiste dhe që ka gjetur shprehje sidomos në një varg degëzimesh të strukturalizmit të sotëm, i përjashton nga sfera e analizës gjuhësore faktorët historiko-shoqërorë, të ashtuquajtur jashtëgjuhësorë (ekstralinguistikë) dhe përpiqet t'i nxjerrë rregullsitë e gjuhës ose nga vetitë biologjike të njeriut në bazë të «psikologjisë së sjelljes» (bihevizorit), siç vepron L. Blumfildi e pasuesit e tij, ose nga ligjërimi i një njeriu të veçuar, siç vepron shkolla strukturaliste e Londrës.

Baza e njëjtë metodologjike, që i bashkon të gjitha këto rryma, bën që zakonisht ato në studimin e gjuhës t'u japin vendin kryesor jo metodave linguistike, por metodave semiotike, të cilat, siç dihet, synojnë që gjuha të studjohet si një sistem i mbyllur shenjash dhe nuk interesohen për funksionet shoqërore të saj, për lidhjet e saj me faktorët e ndryshëm historikë në këtë ose atë fazë të zhvillimit, për rolin e saj në proceset e njohjes etj. Duke u universalizuar, këto metoda formale kërkimore fitojnë cilësi metodologjike dhe, sipas filozofisë kantiane të shkencës, fillojnë të përcaktojnë objektin e vetë shkencës gjuhësore, thelbin e natyrën e tij. Me shfrytëzimin e gjërë të kibernetikës e të njehsimeve matematikore disa nga këto rryma kanë arritur edhe një varg rezultatesh praktike, sidomos në fushën e gjuhësisë së zbatuar e në mënyrë të veçantë në fonologji, e cila ka lidhje të ngushta me drejtshkrimin e me drejtshqiptimin. Krahas arritjeve të gjuhësisë «tradicionale», shkencë jonë gjuhësore ka filluar t'i shfrytëzojë edhe këto rezultate të reja; ajo ka nevojë dhe mund t'i shfrytëzojë ato edhe më mirë në të ardhmen, sidomos në fushën e studimit sinkronik të gjuhës së sotme shqipe e, para së gjithash, të gjuhës letrare. Por ne nuk i ngatërrojmë këto rezultate të reja të metodave studimore e të zbatimit të teknikës moderne në kërkimet gjuhësore me bazat metodologjike idealiste të rrymave të lartpërmendura dhe nuk mund të mbështetemi tek ato për zgjidhjen teorike të problemeve kardinale të gjuhës sonë kombëtare.

5) Shih W. Humboldt, *Ueber die Verschiedenheit des menschlichen Sprachbaues und ihren Einfluss auf die geistige Entwicklung des Menschengeschlechts*, Werke, 6 Band, Berlin, 1848. Duhet thënë se këtë pikëpamje, para Humboldtit e ka shprehur Herderi që në shek. XVIII.

Jeta e gjuhëve të ndryshme e studimi i tyre prej më se një shekulli kanë vërtetuar se metodologjia që lejon të kuptohen, të vlerësohen e të zgjidhen më drejt këto probleme është materializmi dialektik e historik, i cili e sheh gjuhën si një fenomen shoqëror që nga lindja e saj dhe deri në kryerjen e funksioneve kombëtare e ndërkombëtare, si një sistem të ndërlikuar semiologjik të një tipi të veçantë, i cili shërben si mjete më i rëndësishëm i marrëdhënjeve midis pjesëtarëve të shoqërisë njerëzore. Ndërsa rrymat e shkollat e ndryshme filozofike e gjuhësore idealiste janë përpjekur e përpiqen ta zgjidhin misterin e gjuhës e të procesit glotogonik brenda «mbretërisë» së gjuhës, Marksi dhe Engelsi e zgjidhën atë, duke zgjidhur misterin e njeriut. Në «Tezat mbi Fojerbahun», Marksi theksoi se «...thelbi i njeriut nuk është një abstrakt, që i takon një individ të veçantë», por «është tërësia e të gjitha marrëdhënjeve shoqërore», se lidhja midis njerëzve nuk mund të kuptohet «vetëm si gjini, si një gjithëbashkësi e brendshme, e heshtur që lidh shumë individë vetëm me vjega natyrore»⁶, por është produkt i marrëdhënjeve shoqërore dhe format e saj përcaktohen nga vetë niveli i lidhjeve në shoqëri e nga format e marrëdhënjeve midis njerëzve në këtë ose atë epokë të caktuar historike. Në përputhje me këtë koncept themelor Marksi dhe Engelsi e përcaktuan edhe gjuhën si produkt të të qenit shoqëror: «Gjuha është aq e vjetër sa edhe ndërgjegja; gjuha është ndërgjegja e vërtetë praktike, që ekziston edhe për të tjerët e, pikërisht për këtë arsye ekziston edhe për mua dhe, ashtu si ndërgjegja, gjuha lind vetëm nga nevoja, nga domosdoshmëria këmbëngulëse e marrëdhënjeve me njerëzit e tjerë»⁷. Në këtë përkufizim përcaktohet qartë edhe raporti midis sociale e individuale në veprimtarinë gjuhësore të njeriut. Krahas kësaj, që në vitet '80 të shekullit të kaluar, Engelsi e shpjegoi edhe natyrën e ndërlikuar të gjuhës si sistem, duke e kuptuar se gjuha ndryshon vazhdimisht, por megjithkëtë, ajo në çdo epokë historike mbetet një fenomen tërësor e unik. Ai depërtoi kështu në dialektikën sinkronike e diakronike të gjuhës, e cila paraqitet njëkohësisht edhe si sistem, edhe si zhvillim. Duke sjellë një kthesë rrënjësore në filozofinë e gjuhës, marksizmi i dha shkencës gjuhësore një bazë të tillë metodologjike që e lejon të qëndrojë në pozita me të vërtetë historike ndaj gjuhës, njeriut prej fenomeneve më universale të organizmit shoqëror.

Teoria marksiste e gjuhës, e gërshtuar me teorinë mbi kombësitë, kombet e kulturën e tyre, jep një bazë metodologjike objektive për ta shpjeguar drejt edhe formimin e gjuhës sonë letrare kombëtare, duke e kërkuar këtë shpjegim jo vetëm në tiparet imanente të strukturës e të sistemit të gjuhës shqipe, jo vetëm në karakterin e marrëdhënjeve midis elementeve të këtij sistemi, por në bashkëveprimin e faktorëve gjuhësorë dhe të faktorëve shoqërorë historikë që çuan në formimin e kombit shqiptar e të shoqërisë së sotme shqiptare. Duke bërë të mundshëm vlerësimin objektiv të tipareve të normës së sotme letrare, kjo teori na lejon të parashikojmë edhe disa nga drejtimet themelore të evolucionit të mëtejshëm të kësaj norme, sepse vetë

6) Shih K. Marks dhe F. Engels, *Veprat*, vëll. 3, f. 3. (bot. 2, rus).

7) K. Marks dhe F. Engels, *Ideologjia gjermane, Veprat*, vëll. 3, f. 29 (bot. 2 rus.).

vlerësimi normativ i gjuhës së sotme letrare nuk mund të bëhet vetëm në bazë të historisë së kaluar të saj, por kërkon të hedhim vështrimin shkencor edhe në të ardhmen. Për këtë arsye ne nuk mund të pajtohemi me këtë ose atë qëndrim negativ ndaj prognozimit lingvistik, që është shfaqur nga përfaqësues të ndryshëm të gjuhësisë së sotme, të cilët, nga pozita metodologjike të tjera, mbrojnë pikëpamjen kategorike se ndryshimet gjuhësore nuk mund të parashikohen, sepse gjoja «e ardhmja nuk është objekt i njohjes, parashikimi nuk është objekt i shkencës»⁸ dhe se «vetëm koha (nënvizuar prej meje — A. K.) do të tregojë në se një fjalë a shprehje e re, një trajtë a ndërtim i ri që hyn në gjuhë, do të mbetet apo jo»⁹. Pa dyshim, një qëndrim i tillë, i cili nuk merr parasysh historinë konkrete të formimit të shumë e shumë gjuhëve letrare kombëtare të popujve evropianë e joevropianë, çon edhe në mohimin e plotë të mundësisë së shoqërisë për të ndikuar mbi normën letrare, pra edhe mbi normën drejtshkimore, në mënyrë të vetëdijshme, në bazë të njohjes shkencore të ligjeve të zhvillimit të gjuhës. Në parim, vetë Marksi dhe Engelsi janë shprehur qartë për këtë çështje. «Kuptohet vetvetiu — thonë ata — se në kohën e vet individët do ta marrin tërësisht nën kontrollin e tyre edhe këtë produkt të gjinisë»¹⁰ (d.m.th. *gjuhën* — A. K.). Historia e gjuhës letrare shqipe, sidomos rrjedhimet e punës së madhe normalizuese të vetëdijshme që është bërë që nga Rilindja Kombëtare e në mënyrë të veçantë pas çlirimit të Shqipërisë, janë një vërtetim tjetër i drejtësisë së kësaj teze që mbështetet te kuptimi i thellë shkencor i marrëdhënjeve dialektike midis objektivës e subjektivës në historinë e popujve e të gjuhëve të tyre.

Në të kaluarën tek ne, krahas mendimeve objektive e të përligjuara historikisht, për këtë problem janë shprehur edhe dy lloj pikëpamjesh — diametralisht të kundërta. Në njërën anë, i është njohur e drejta absolute jo vetëm shoqërisë, por edhe këtij ose atij individit të veçantë për të vendosur për pranimin ose jo të një fakti gjuhësor, për ndryshimin e normës jo vetëm në drejtshkrim, por në vetë strukturën fonetiko-gramatikore e leksionare të gjuhës letrare shqipe. Këtu e kanë burimin përpjekjet e shkrimtarëve a të gjuhëtarëve të veçantë për «të krijuar» një gjuhë letrare, përpjekjet për amalgama e shartime artificiale në strukturën fonetike e morfologjike të shqipes letrare, apri-

8) Shih E. Coseriu, *Cincronia, diacronia e historia. El problema del cambio linguistico*. Montevideo, 1958, (5.3.6). Duhet thënë, se ashtu si edhe studjues të tjerë, ky autor në të njëjtën vepër shpreh edhe mendime kundërthënëse. Duke e zbutur më poshtë pohimin e tij kategorik, ai pohon, p.sh. që «ka mundësi të thuhet vetëm se në kushte të caktuara të njohura për ne mund të bëhen ndryshime të këtyre ose të atyre tipeve» (5.3.6), se pranimi i inovacionit si normë «i përgjigjet kurdoherë nevojës së shprehjes (necesidad expresiva): kjo nevojë mund të jetë kulturele, sociale, estetike ose funksionale» ose se ky është një akt, që përcaktohet nga kultura, shija dhe arsyeja praktike» (po aty, 4.3.3).

9) A. A. Leontjev, *Budushçee jazika kak problema kulturni reçi*, «Voprosi kulturni reçi», v. 8, 1967, f. 7.

10) K. Marks dhe F. Engels, *Ideologjia gjermane*. Veprat, vëll. 3, f. 247 (bot. 2 rus., Moskë, 1955).

orizmi dhe subjektivizmi në trajtimin e problemeve të tilla kryesore të gjuhës letrare shqipe, si ai i bazës së saj dialektore etj. Nga ana tjetër, janë shfaqur qëndrime skeptike e pesimiste në lidhje me vetë mundësinë e formimit të një gjuhe letrare të vetme shqipe. Këto koncepte janë mishëruar, ndër të tjera edhe në teorinë e pritjes pa fund, duke ja lënë kohës të vendosë gjithshka deri në shkrirjen e plotë të dialekteve. Qëndrime të tilla, të cilat ndonjëherë kanë arritur deri në fatalizëm, kanë qenë shfaqje të moskuptimit të vijës historike të zhvillimit të popullit tonë e të gjuhës së tij, të koncepteve që e kërkonin zgjidhjen e problemit të gjuhës letrare të përbashkët shqipe në të kaluarën e jo në të ardhmen, duke e argumentuar këtë herë-herë me krahasime e paralele të jashtme antihistorike, si edhe të indentifikimit të rrugës së zhvillimit të dialekteve me atë të gjuhës letrare.

Të dyja këto koncepte të kundërta kanë qenë mjaft të përhapura tek ne përpara çlirimit, por aty-këtu ato u shfaqën edhe në vitet e para pas çlirimit, sidomos në Konferencën e dytë gjuhësore të vitit 1952, ku ato tingëlluan si një anakronizëm. Shkenca e re gjuhësore shqiptare është çliruar me kohë prej tyre, duke përvetësuar e zbatuar gjithnjë më thellë metodologjinë materialiste historike¹¹.

Si na paraqitet procesi i formimit të gjuhës sonë letrare i parë nga këto pozita metodologjike objektive? Që nga «Formula e pagëzimit», «Ungjilli i pashkëve», «Meshari» i Buzukut e nga veprat e tjera të shekujve XVI—XVII e gjejmë shqipen e shkruar të dokumentuar në dy variante letrare kryesore, të ndërtuara mbi baza dialektore. Ndër këto vepra, në vështrimin e mirëfilltë shkencor gjuhësor, zë një vend krejt të posaçëm «Fjalori latinisht-shqip» i Frang Bardhit (1635), ku për të parën herë shqipja vihet ballë për ballë në një rrafsh tërësor e të kodifikuar leksikor me latinishten, gjuhën më të përpunuar ndërkombëtare të asaj kohe. Të gjitha këto dëshmi, vërtetojnë se gjuha shqipe e kishte kapërcyer me kohë strukturën dialektore-fisnore dhe kishte përvijuar mjaft qartë një strukturë dialektore-territoriale, që është tipike për kombësinë në kushtet e feudalizmit dhe që përbën fazën e dytë në procesin e evolucionit të dialekteve. Variantet letrare dialektore të asaj kohe dalin para nesh jo si një pasqyrim i drejtpërdrejtë i një të folmeje të vetme të Veriut a të Jugut, por si një përpjekje përgjithësimi në shkallë të një grupi të folmesh a nëndialekti. Dhe kjo dëshmon se monumentet e njohura të shqipes, që u kanë shpëtuar rrebesheve të historisë, nuk janë të parat shkrime të saj, por përfaqësojnë një shkallinë mjaft të ngritur të përpunimit letrar, ndërsa shkrimet e para do të kenë qenë pasqyrime të të folmeve të veçanta, me përgjithësime brenda rrethit të një të folmeje, pasi, siç dihet, në shkrim kemi gjithmonë një farë përgjithësimi¹². Të marra në tërësinë e tyre, shkrimet

11) Për vlerësimin e përgjithshëm të teorive e pikëpamjeve që janë shfaqur deri më sot rreth formimit të gjuhës letrare shqipe, shih A. Kostallari. *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, «Studime filologjike», 1970, 2, f. 6-11).

12) E. Çabej ka shprehur mendimin se «në Shqipëri ka qenë formuar..., së paku që në mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike, me një ortografi gjer diku të caktuar» (shih «Meshari» i Gjon Buzukut, Tiranë 1968, f. 25).

d shqipe të shekujve XVI-XVIII që arrijnë shkallën më të lartë të përpunimit në prozën e Bogdanit, megjithëse dallohen midis tyre nga një varg veçorish, i takojnë periudhës parakombëtare të gjuhës letrare shqipe. Këtë e përcaktojnë si vetë tiparet gjuhësore, ashtu edhe funksionet shoqërore të tyre, ndër të cilat ka mbizotëruar funkcioni fetar. Dukuritë e shek. XVIII nuk e ndryshuan në thelb këtë gjendje. Mund të themi se në këtë shekull nisin të ziejnë në Shqipëri disa procese të rëndësishme shoqërore, herë në mënyrë më të thellë e të mbytur, herë në mënyrë më të dukshme. Pa këto procese nuk mund të kuptohet epoka e madhe e shek. XIX, por në vetvete ato nuk shënojnë një etapë të re cilësore as në planin ekonomik-shoqëror e politik, as në atë kulturor. Një kalim i tillë nuk u bë as në fushën e gjuhës letrare. Dhe kjo ka arësye objektive. «Në gjithë botën — thotë Lenini — epoka e fitores përfundimtare (nënvizuar prej meje — A. K.) të kapitalizmit mbi feudalizmin ka qënë e lidhur me lëvizjet kombëtare. Baza ekonomike e këtyre lëvizjeve është kjo: për fitoren e plotë të prodhimit të mallrave është e domosdoshme që borgjezia të vërë në dorë tregun e brendshëm, është i domosdoshëm bashkimi shtetëror i territoreve me popullsi që flet në të njëjtën gjuhë, duke hequr çdo pengesë që mund të ndalojë zhvillimin e kësaj gjuhe dhe ngulitjen e saj në letërsi, (nënvizuar prej meje — A. K.). Gjuha është mjeti më i rëndësishëm i marrëdhënjeve midis njerëzve; njësia e gjuhës dhe zhvillimi i saj pa pengesa (nënvizuar prej meje — A. K.) është një nga kushtet më të rëndësishme të qarkullimit të mallrave me të vërtetë të lirë e të gjerë, që t'i përgjigjet kapitalizmit të sotëm, të grupimit të lirë e të gjerë të popullsisë nëpër të gjitha klasat e veçanta, më në fund, është kusht për lidhjen e ngushtë të tregut me cilindo e me secilin pronar e pronarth, shitës ose blerës. Për këtë arësye, krijimi i shteteve kombëtare, që plotësojnë më mirë këto kërkesa të kapitalizmit të sotëm, është synim i çdo lëvizjeje kombëtare. Janë faktorët më të thellë ekonomikë që e kërkojnë këtë dhe prandaj për gjithë Evropën Perëndimore — dhe jo vetëm për të, po për gjithë botën e qytetëruar tipik, normal për periudhën kapitaliste është shteti kombëtar»¹³. Në periudhën e lartpërmëndur në Shqipëri, megjithë shenjat e para të një shturrjeje të marrëdhënjeve feudale, nuk ishin krijuar akoma kushtet e domosdoshme, për të cilat flet Lenini. Gjendja e prapambetur e marrëdhënjeve ekonomik-shoqërore feudale, niveli kulturor i ulët e përçarja fetare, rëndoheshin e ndërlikoheshin edhe më shumë nga një varg faktorësh të jashtëm — nga pushtimi i huaj dhe nga përpjekjet e forcave të tjera nga Lindja e nga Perëndimi për të vendosur sundimin e tyre shpirtëror, ideologjik, si bazë për sundimin politik që ato synonin. Të gjitha këto ishin pengesa të pakapërcyeshme në atë kohë për zhvillimin e lirë të gjuhës letrare shqipe. Qëndresa e popullit tonë ndaj këtij presioni të dyfishtë u shtua shumë, sidomos aty nga dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XVIII, por kushtet objektive ishin të tilla që nuk lejonin akoma të delnin në arenë ato forca që mund të merrnin përsipër e të vinin në jetë detyrën historike

13) V. I. Lenin, *Mbi të drejtën e popujve për vetëvendosje*, Veprat, vëll. 20, f. 368-369 (bot. 4 rus.).

të çlirimit të atdheut e të krijimit të një shteti kombëtar, ndër të tjera, edhe të zhvillimit *pa pengesa* të gjuhës letrare shqipe.

Këto forca dolën në shekullin XIX, në kushte të reja historike. Dhe ato vepruan me një kuptim të qartë e largpamës të misionit të tyre. Për këtë mjafton të krahasojmë, p.sh. tezën e mësipërme të Leninit me kërkesën programore që parashtrohet në një nga organet më përparimtare të Rilindjes Kombëtare: «... shqiptarët duhet të fitojnë më parë lirinë e tyre — thuhet në kryeartikullin e këtij organi —, lirinë që të veprojnë si të duan ata vetë dhe si është e drejta e tyre, e pastaj ata do të kenë lehtësi dhe kohë që t'ja vënë mendjen zhvillimit të gjuhës së tyre dhe në përgjithësi edukimit të tyre. Liria... është një kapital ose një pronë, me anën e së cilës njeriu mund të ushtrojë tregëtinë e tij ose profesionin e tij. Pa kapitale tregëtari s'mund të bëjë tregëti, pa tokë bujku s'mund të prodhojë gjë, pa liri kombet s'mund të zhvillohen dhe të shkojnë mbarë. Pra vetia (d.m.th. nevoja — A. K.) më e parë e më kryesore, si për individët ashtu edhe për kombet, është liria personale e kombëtare»¹⁴. Siç dihet, lufta për gjuhën letrare shqipe, për mësimin e lëvrimin e lirë të saj, për njësimin, pastrimin e pasurimin e saj u bë një nga qëllimet e mjetet kryesore të lëvizjes së gjerë të Rilindjes kombëtare.

Lind pyetja: ~~kur mund të themi se në fushën e gjuhës letrare bëhet kapërcimi nga periudha parakombëtare në atë kombëtare?~~ Ky kapërcim nuk u bë dhe as mund të bëhej menjëherë, por ishte rezultat i disa dhjetëvjeçarëve. I pari fakt real që paralajmëroi se po lindte një periudhë e re në historinë e shqipes letrare ishte «Evetari» origjinal i Naum Bredhit — Veqilharxhit, që u hartua në vitet '20 të shek. XIX e u botua më 1844 e 1845. Kjo nuk ishte një vepër e rastit, por ishte shprehje e qartë e vetëdijes kulturore e politike të një epoke të re. «Mos i vështroni të vogëlmit të ti — shkruan Veqilharxhi në parathënjën e Abetares së tij me pak fletë — koha do t'i rrëfenjë të mathtë e, të rëndit të ti...»¹⁵. Brezi i parë i veprimtarëve të Rilindjes frymëzohej gjerësisht nga një ide e madhe atdhetare e përparimtare iluministe — kjo ishte, në qoftë se mund ta quajmë kështu, «ideja e mbjellësit». «Le të hedhim farën e mirë» — shkruante me besim të patundur në të ardhmen N. Veqilharxhi në thirrjen që i drejtonte popullit — me siguri natyra do t'i japë asaj ngjallje, çelje e rritje dhe, pa dyshim, pemët e bukura e të ëmbla brezat që do të vijnë sot e tutje do t'i vjelin, duke bekuar mbjellësit e mirë edhe farën»¹⁶. Vazhden e kësaj ideje e gjejmë të pandërprerë për disa dhjetëvjeçarë, Ndër të

14) Shih «*I foni tis Alvanias*» («*Zëri i Shqipërisë*»), nr. 4, 20 tetor 1879 (citohet sipas përkthimit të dhënë në përmbledhësin *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Tiranë 1971, vëll. I, f. 227.

Artikulli, me sa duket, është shkruar nga rilindësi i shquar Anastas Kullurioti).

15) Shih N. Veqilharxhi, «*E parthënme mbi djelmt e rinj shqiptarë*», *Evetari shqip*, 1845.

16) Shih «*Kalendari Kombiar*», Sofje, 1906, f. 52.

tjerë, atë e shpreh edhe Naimi, në lidhje të drejtpërdrejtë me lulëzimin e gjuhës:

«Si lum kush zë të mbjellë,
Lum kush vë këtë pemë,
Se kjo ka për të pjellë,
S'mbulohetë me remë»¹⁷.

Me të vërtetë rilindësit «mbollën» një farë shumë të mirë, që mbiu shpejt në një tokë pjellore. Prej saj u rrit një «pemë» e shëndetshme dhe e fuqishme. Dhe ata jo vetëm «mbollën», por edhe «korrën». Frytet e tre brezave të rilindësve ne i shohim sot, me të drejtë, si vlera klasike të letërsisë e të gjuhës sonë letrare, të kulturës sonë kombëtare. Pikërisht me shkrimet e rilindësve bëhet hap pas hapi kalimi nga periudha parakombëtare në një shkallë të re cilësore — në periudhën kombëtare të gjuhës sonë letrare. Në vitet '60 të shekullit të kaluar për të parën herë në historinë e shqipes letrare gjejmë të mishëruar, si qëllim të vetëdijshëm, afrimin e të dy varianteve letrare dialektore në shkrim, jo vetëm si dëshmi të afërisë së tyre si variante të një gjuhe të vetme, por edhe si një hap historik real përpara për njësimin e gjuhës së shkruar. Këtë hap e bëri gjuhëtari e shkrimtari i njohur K. Kristoforidhi. Me veprën e tij të shumanshme ai u bë nismëtari i një dukuri të pashembëllt në historinë e deriatëhershme të shqipes së shkruar — nga i njëjti autor të shkruhen të dyja variantet letrare. Kështu në vitet '60 të shekullit të kaluar zë fill periudha kombëtare në historinë e gjuhës letrare shqipe, e cila ka arritur fazën më të lartë në kohën tonë. Sot, duke u mbështetur në veçoritë historiko-shoqërore e gjuhësore të rrugës më se njëshekullore e të vështirë që ka përshkuar ajo, mund ta ndajmë këtë periudhë në tri etapa: (a) që prej viteve '60 të shekullit XIX deri në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar (1912); (b) prej 1912 e deri më 1944; (c) prej çlirimit (1944) e deri në ditët tona. Të trija këto etapa, në të cilat kanë ecur krahas edhe lëvrimi, edhe studimi i shqipes letrare, i bashkon një vijë e vetme zhvillimi — vija e konvergjencës gjuhësore gjithnjë në rritje e pa kthime prapa, e cila ka pasur e ka si mbështetje konvergjencën kombëtare ekonomiko-shoqërore, politike e kulturore. Por çdo etapë ka edhe tiparet e veta dalluese, frytet e saj gjuhësore e letrare.

↓ Në etapën e parë që u zhvillua në frymën e Rilindjes Kombëtare, të qëllimeve të saj përparimtare e demokratike si edhe të kontradiktave të saj, u hodhën themelet e gjuhës së sotme letrare shqipe dhe u përvijua drejtimi kryesor i zhvillimit të saj të mëtejshëm. Gjuha letrare shqipe, duke u mbështetur në trashëgimin më të mirë të traditës së kaluar, pa u shkëputur nga kjo traditë e njëkohësisht duke u ushqyer gjerësisht nga gurra e gjallë e gjuhës popullore, ku ishin ngjizur edhe disa koine ndër-krahinore të mishëruara sidomos në folklor, arriti të krijonte trajta mjaft të përgjithësuara e të njësuara në vijën e thelbit iluminist e çlirimtar të programit gjuhësor të Rilindjes: shkrimet shqipe t'i shërbenin «të ndrituarit të kombit», «të ngjallturit të gjuhës shqipe e të bashkuarit të

17) N. Frashëri, «Gjuha jonë», Lulet e verësë, 1890.

dialekteve të saj», sepse, siç e theksonte Sami Frashëri, «shumë gjuhë e djalekta sjellinë ndarje e mërgim»¹⁸. Krahas kësaj, ajo u pastrua nga shumë fjalë të huaja që i kishin zënë frymën dhe u pasurua mjaft si nga zbulimi i thesarit popullor që ishte ruajtur në krijimtarinë poetike gojore e në gjuhën e folur, ashtu edhe nga shfrytëzimi i mundësive të gjera të sistemit fjalëformues të shqipes. Përpjekjet për ta bërë shqipen letrare, siç thotë Samiu, një gjuhë «nga më të bukuratë», të aftë për të shprehur «gjithë dituritë»¹⁹ i dhanë shkas procesit të shtresëzimit të saj stilistikor dhe kjo gjeti shprehje në krijimin e një letërsie të gjerë artistike, publicistike, didaktiko-shkencore, shkencore-popullarizuese, në botimet e folklorit etj. Kjo punë e madhe krijuese letrare u shoqërua edhe nga studimi i strukturës gramatikore, si edhe nga mbledhja e përpunimi i leksikut të shqipes. Sinteza e kësaj veprimtarie shkencore ishin sidomos gramatikat e K. Kristoforidhit e të S. Frashërit dhe «Fjalori i gjuhës shqipe» i Kristoforidhit — i pari fjalor jo dialektor, por kombëtar, që mbeti si model i pakapërcyeshëm gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit tonë.

Kështu, Rilindja bëri hapin më të vështirë për krijimin e një gjuhe letrare shqipe. Ajo e nxori gjuhën tonë të shkruar nga gjendja e prapambetur e shekujve të kaluar, e vuri në një rrugë të re dhe shtroi krijimin e gjuhës së përbashkët letrare si një çështje të madhe për gjithë kombin tonë. Ajo u mbyll sidomos me tre rezultate vendimtare për të ardhmen e gjuhës sonë të shkruar. Së pari, u krijua për këtë gjuhë një alfabet i vetëm. Së dyti, në vend të mozaikut shumë të copëzuar të shkrimeve të së kaluarës, që mbështeteshin në të folme krahinore e nëndialektore, u krijuan dy variante letrare mbi dy baza kryesore dialektore: a) një koine letrare gjithë-jugore me një bazë të gjerë e prandaj edhe të hapur për të thithur elemente nga dialekti tjetër; kjo koine mbizotëroi jo vetëm nga përhapja, por sidomos nga niveli mjaft i lartë i njësisimit; b) varianti letrar verior, i shprehur në dy bashkëvariante — në bashkëvariantin e mesëm e në atë veriperëndimorin. Së treti, pavarësisht nga shkalla e njësisimit të varianteve letrare, gjuha e shkrimit gjatë Rilindjes i zgjeroi mjaft funksionet e saj shoqërore: ndërsa në shekujt e mëparshëm ajo na del kryesisht në vepra me karakter fetar, pra nga pikëpamja funksionale mbeti më tepër një gjuhë monovalente, tashti ajo u bë polivalente. Vetëm se funksionet e saj nuk kishin marrë një zhvillim të gjerë e të barabartë në të gjitha sferat, prandaj polivalenca e saj ishte akoma mjaft asimetrike. Kjo asimetri u përcaktua, në radhë të parë, nga faktorë jashtëgjuhësorë: ndër ta kryesori ishte se në atë kohë populli ynë nuk kishte krijuar akoma shtetin e tij të pavarur.

Etapa e dytë ¹⁹¹²⁻¹⁹⁴⁴ në historinë e gjuhës sonë letrare kombëtare fillon pikërisht me themelimin e këtij shteti. Gjuha letrare duhej t'i shërbente tashti forcimit e zhvillimit të tij. Kjo kërkonte që ajo të ecte më tej në rrugën e njësisimit e të pasurimit dhe njëkohësisht krijonte kushte më të favorshme për mësimin e lirë të gjuhës amtare në shkollat fillore e

18) Shih «Një letër e Sami Frashërit mbi Lidhjen e Prizrenit», Buletin për Shkencat shoqërore, Tiranë, 1954, II, f. 114-116 (botuar nga Dh. S. Shuteriqi).

19) S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?*, Bukuresht, 1899, kap. XI.

të mesme e për lëvrimin e saj në gjithë Shqipërinë, për pasojë edhe për forcimin e bashkëveprimit e të ndërdepërtimit të varianteve letrare. — Ndërsa gjatë Rilindjes bazat patriotike shqiptare jashtë atdheut luajtën një rol të dorës së parë në përpunimin e gjuhës letrare, tashti puna kryesore u përqëndrua brenda Shqipërisë.

Në këto kushte, pa dyshim, gjuha jonë letrare u ngrit në një nivel më të lartë në të gjitha aspektet. Por rruga, nëpër të cilën ajo eci përpara qe me shumë dhimbje. Gjendja ekonomiko-shoqërore e kulturore vazhdoi të qëndronte e prapambetur, tërë struktura e shtetit feudoborgjez mbahej më këmbë duke e rënduar shtypjen klasore e duke thelluar përçarjen krahinore e fetare. Ky regjim bënte çmos që fjala e shkruar, si përçuese e dritës dhe e ideve përparimtare, të arrinte sa më pak tek masat e gjera të qytetit e të fshatit. Etja e fëmijëve të popullit për të mësuar shkrim e këndim mbytej shpeshherë nga uria e egër, që krijoi «legjendën e misrit». Në kushtet e ashpërsimit të vazhdueshëm të luftës së klasave, në këtë etapë u shfaqën haptazi disa prirje largimi nga politika gjuhësore e trashëguar nga Rilindja, prirje që ndofta në Rilindje ishin akoma latente. Gjatë viteve '20-'30 u bë bipolarizimi i forcave që luftonin për të zgjidhur problemin e gjuhës letrare. Në njërën anë, u radhitën ata që e thelluan vijën themelore të Rilindjes dhe vazhduan me këmbëngulje përpjekjet për njësimin e shqipes së shkruar. Këto ishin forcat demokratike që lulëzimin e gjuhës letrare e lidhnin ngushtë me demokratizimin e përparimin e gjithanshëm të shoqërisë shqiptare. «Shqipëria, bashkë me popullin e saj — shkruante më 1921 një organ që shprehte synimet e këtyre forcave — dëshëron të shohë një përparim dhe i ka shtënë syt'e saj nga Perëndimi. Do t'i shohë fushat e saj të lëruara pas mënyrës së re; do t'i shohë pyjet e prera pas mënyrës moderne, që të mos na mbeten nesër të shkreta; do t'i shohë mademet e eksploatuara pa e shtënë popullin nënë robërinë ekonomike; do t'i shohë shkollat e përparuara dhe baras me të Europit; do ta shohë qytetarin, fshatarin dhe bujkun të saj kryelartër, të pasur, të lumtur dhe çdo qendër të madhe a të vogël, të lidhura me brezat e hekurta (= hekurudha — A. K.). Do ta shohë dhe do ta pjekë Korçën me Shkodrën në 5-6 sahat; do ta përziejë Verinë me Jugën, ta heqë fanatizmin dhe të krijojë një komb të përbashkëtë, të përparuar, të qytetëruar dhe të kulturuar në çdo pikëpamje»²⁰. Me përpjekjet e këtyre forcave u bënë disa hapa të rëndësishme përpara: vendimet e Komisionit Letrare të Shkodrës për të çmuar më tej njësimin e gjuhës letrare e të drejtshkrimit, vendimet e Kongresit Arësimor të Lushnjës (1920) dhe një varg vepri-mesh për të nxitur kujdesin e botës arësimore-kulturore e shkencore për zgjidhjen e çështjes së gjuhës letrare kombëtare, si edhe vetë lëvrimi i kësaj gjuhe me synime konvergjente ishin pikërisht fryt i përpjekjeve të këtyre forcave. Kundër tyre, nxorën krye disa pikëpamje divergjente, lokaliste e partikulariste, antikombëtare e antidemokratike e njëkohësisht edhe antihistorike, që ishin shprehje e luftës së klasave në plan kombëtar e ndërkombëtar. Nga pozita e zgjidhjes së problemit gjuhë-

20) Shih «Gazet'e Korçës», 18 janar 1921, f. 1 (kryeartikulli «Dy fjalë kandidatëve për deputetë»).

sor mbi baza dialektore e nëndialektore të kulluara, ose duke idealizuar gjuhën e teksteve fetare të shek. XVI-XVII, ato u ngritën kundër vendimeve të Komisionit Letraro e atyre të Kongreseve arësimore, kundër një gjuhe letrare të vetme për gjithë kombin shqiptar dhe e shndërruan këtë çështje në një mjet të shantazhit politik. Flamurin e këtyre forcave reaksionare e morën sidomos krerët e urdhërave katolike. Ndërsa zëdhënësi i Urdhërit të Françeskanëve, Gjergj Fishta vazhdonte ta sulmonte gjuhën letrare që ecte drejt njësimit, si një «gjuhë mushke», «gjuhë bastardhe e stramastike», Urdhëri i Jezuitëve më 1938 shpalli haptazi programin e tij gjuhësor, duke theksuar se «unjisimi i tashëm (lexo: «përpjekjet për një gjuhë të vetme letrare» — A. K.) kishte për të kënë fillimi i zhgatërrimit» dhe duke u kërcënuar me formulën «bashkim dialektesh = dasi zëmrash; dallim dialektesh = bashkim zëmrash»²¹. Të gjitha këto pengesa dhe paaftësia e shtetit të atëhershëm për të ndikuar sadopak për kuptimin dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes së gjuhës e ngadalësuan, e ndërlikuan dhe e vështirësuan mjaft procesin e normalizimit qoftë edhe në një sferë të caktuar. Megjithë vendimet qeveritare për njësimin e gjuhës zyrtare, edhe ky njësim nuk u bë asnjëherë. Mjafton të përmendim një shembull kuptimplotë: në një telegram të nënshkruar nga vetë mbreti e të botuar në shtypin zyrtar më 1937 në pesë radhë ka shtatë gabime e shkelje të normës gjuhësore të pranuar nga vetë qeveria²². Është pikërisht gjendja e rëndë e viteve '30 që solli lindjen e koncepteve skeptike e bile edhe të dëshpërimit në qarqe të caktuara intelektualësh si përsa i përket normalizimit të gjuhës letrare, ashtu edhe për probleme të tjera të mëdha shoqërore. Në këtë mjedis u shfaq, si një variant i «teorisë së pritjes» edhe «teoria e mbinjeriut», që do t'i sillte shpëtimin edhe gjuhës, edhe popullit tonë. Këta intelektualë, të djegur nga dëshira për ta parë gjuhën tonë letrare të njëjtë e të përsosur, pritnin që të delte «n'orizontin tonë një yll», një «mbinjeri që... kishte me na mahnitë me zbulimin e thesarit qi mshoh në gji gjuha e jonë mijavjeçare, tue na folë me një ambëlsi të pashijueme kurrë prej nesh»²³. Kjo nuk ishte një dukuri e veçuar vetëm në fushën e gjuhës. Pak vite më parë edhe Migjeni, me zemër të plagosur nga mjerimi i popullit, kishte kërkuar shfrim në një ditiramb nitçean. Por shpëtimin popullit tonë dhe normalizimin gjuhës së tij letrare nuk ja solli mbinjeriu, po revolucioni popullor e socialist, i cili krijoi për të parën herë kushtet e nevojshme për një zhvillim me të vërtetë të lirë e pa pengesa të gjuhës sonë letrare në shkallë kombëtare. Këtu fillon etapa e tretë e formimit të kësaj gjuhe, përmbajtja themelore e së cilës është procesi i kristalizimit përfundimtar të normës letrare si normë kombëtare në të gjitha nivelet e strukturës gjuhësore e në funksionet e saj shoqërore.

Kur u çlirua Shqipëria më 1944 as gjuha letrare e as drejtshkrimi

21) Shih «Çashtja e gjuhës», art. i redaksisë në rev. «Leka», 1938, Nr. 6-7, f. 270-271.

22) Shih gaz. «Shtypi», 3 maj 1937.

23) Shih Haki Stërmilli, art. Gjuha letrare në «Tomori», 1940, nr. 180, f. 3.

i saj nuk ishin njësuar. Por në raportet midis varianteve letrare etapa e dytë tridhjetë-e-ca-vjeçare kishte sjellë disa ndryshime jo të papërfillshme. Koineja letrare jugore e kishte zgjeruar edhe më tepër përhapjen e saj, ndër dy bashkëvariantet veriore ai i mesmi kishte arritur gjithashtu një rritje sasiore e cilësore të ndjeshme, ndërsa rrethi i veprimit i bashkëvariantit letrar veriperëndimor ose i së ashtuquajturës «shkodranishte letrare» ishte ngushtuar aq shumë, sa edhe pushtuesit fashistë, me gjithë kërkesën e urdhërave katolike që ishin një mbështetje e tyre e vjetër në Shqipëri, nuk pranuan ta përdornin si gjuhë themelore të organeve të tyre, por ju drejtuan kryesisht koinesë letrare jugore dhe variantit letrar verior të mesëm, duke shpresuar se kjo do t'ua lehtësonte përhapjen e ideve të tyre në gjithë Shqipërinë»²⁴.

Pas fitores së revolucionit popullor në jetën e gjuhës sonë letrare nuk ndodhi ndonjë «përmbysje», as nuk pati ndonjë «diktat gjuhësor». Por kthesa historike që përmbysi shoqërinë e vjetër të shtypjes e të errësirës, nuk mund të mos krijonte kushte cilësorisht të reja edhe për vetë jetën e zhvillimin e gjuhës letrare, të këtij tipari themelor të njësisë së kombit dhe njëkohësisht të formës kryesore e të përqëndruar të kulturës sonë kombëtare. Këto kushte në mënyrë objektive ndikuan në vetë drejtimin e evolucionit të gjuhës letrare dhe në ritmet e zhvillimit të procesit gjuhësor. Ato sollën rrjedhime cilësore edhe në vetëdijen gjuhësore të shoqërisë sonë.

Ndër kushtet e reja që krijoi sistemi socialist në Shqipëri e që burojnë nga ndryshimet e thella ekonomiko-shoqërore të pasqyruarit, mund të dallojmë katër faktorë që kanë rëndësi të veçant për procesin gjuhësor: (a) zhvillimi i vrullshëm i arësimit e i kulturës; (b) ndryshimet e thella në gjirin e popullsisë dhe procesi i urbanizimit; c) rritja e rolit të kryeqytetit; ç) politika e drejtë gjuhësore e shoqërisë sonë.

(a) Hallka e parë me rëndësi vendimtare e revolucionit tonë arësimit e kulturor ishte zhdukja e analfabetizmit në të gjitha moshat veprimtare, sepse nuk ka se si të mendohet normalizimi i gjuhës letrare në plan kombëtar, kur mbi 80% e popullsisë nuk di shkrim e këndim. Krahas kësaj, hapa të domosdoshme e shumë frytdhënëse qenë edhe kombëtarizimi e shekullarizimi i plotë i shkollës, nxjerrja e saj nga ndikimi i drejtpërdrejtë a i tërthortë i grupeve kulturore-gjuhësore lokale ose i shteteve të huaja dhe zhdukja e kaosit gjuhësor në arësimin e përgjithshëm të detyrueshëm, kaos që shkolla shqipe e kishte ndjerë si një plagë të rëndë në të kaluarën, por nuk e kishte shëruar dot. Sot në Shqipëri është bërë masiv jo vetëm arësimi tetëvjeçar, por edhe i mesmi e i larti. Një karakter të tillë masiv ka marrë edhe puna kulturore, e cila shprehet sidomos në dhjetëfishimin e numrit të të gjitha botimeve në krahasim me 1938-ën, ndërsa tirazhi i tyre është njëzetfishuar. Tashti pothuajse 100% e të gjitha botimeve dalin në një gjuhë letrare të normalizuar. Rëndësi të posaçme ka rritja, sidomos në këto 15 vjetët e fundit, e peshës specifike të veprave të letërsisë artistike, lulëzimi i pa-shembëllt i të gjitha gjinive letrare, krahas peshës së madhe të tekste-

24) Për karakterin e vetëdijshëm të këtij veprimi shih E. Koliqi, art. «Akt-besimi», rev. «Shkëndija», 1940, I, nr. 1, f. 7.

ve shkollore e të publicistikës, sepse letërsia artistike, duke pasur si veçori themelore krijimin e figurave me anë të fjalës, luan një rol të dorës së parë në formimin e gjuhës letrare kombëtare e në zhvillimin e saj, si edhe në përhapjen e normës letrare në masat e gjera. Të gjitha këto, së bashku me rolin e madh që luajnë në jetën tonë radioja, konferencat, leksionet e mbledhjet publike etj., ku përpunohet *trajta e folur* e gjuhës letrare, tregojnë se rrezja e veprimit të normës letrare është shtrirë në të gjitha skajet e vendit. Masat e gjera janë bërë tashmë edhe objekt, edhe subjekt i gjuhës letrare, duke zhvilluar një veprimtari të gjallë gjuhëkrijuese.

b) Ndryshimet në gjirin e popullsisë kanë luajtur një rol të madh si me anën e tyre sasiore, të jashtme, ashtu edhe me anën cilësore, të brendshme. Popullsia e Shqipërisë, siç dihet, pas çlirimit është dyfishuar në krahasim me 1938-ën; ritmet e shtimit të saj në këtë periudhë kanë qenë dy herë e gjysmë më të shpejta se në periudhën 1923-1945. Kjo do të thotë se pjesa më e madhe e popullsisë veprimitare të vendit tonë e ka bërë e po e bën formimin gjuhësor pikërisht në etapën e fundit të kristalizimit të normës letrare kombëtare. Krahas kësaj, vetë struktura e popullsisë e përhapja e saj gjeografike ka ndryshuar rrënjësisht. Për gjuhën letrare, e cila mbështetet në radhë të parë në procesin normalizues që zhvillohet në gjuhën e qyteteve, ka rëndësi që pas çlirimit tek ne numri i qyteteve është rritur më se dy herë, popullsia e tyre përbën sot 33.8% të gjithë popullsisë dhe karakteri i saj nga prejardhja nuk është më, ashtu si përpara çlirimit, pak a shumë homogjen, vendës, por është i përzier: në vitet 1960-71, p.sh., shtimi mekanik i popullsisë së qyteteve është bërë më se 60% me banorë të ardhur nga disa rrethe dhe vetëm rreth 40% me banorë të ardhur nga fshatrat e rrethit përkatës²⁵. Me drejtimin e ri që i dha urbanizimit zhvillimi i planifikuar i ekonomisë, shpërndarja e qyteteve dhe e qendrave industriale ka marrë përpjestime më të drejta dhe nuk ka më zona të gjera tërësisht ose pothuajse tërësisht fshatare, siç ishin në të kaluarën krahinat e Shqipërisë Verilindore, Lindore e Juglindore. Të gjitha këto kanë zgjeruar shumë bashkëveprimin gjuhësor ndër-dialektor në vetë popullsinë e qyteteve dhe e kanë shtuar e e kanë bërë të pandërprerë ndikimin gjuhësor letrar të qytetit në fshat, ku ndodhen mbartësit kryesorë të ligjërit dialektor. Nga ana tjetër, procesi i thellë i «qytetarizimit» të fshatit ja ka ndërruar atij fytyrën dhe e ka lidhur drejtpërdrejt me jetën e shumanshme të gjithë vendit, duke e bërë edhe atë një qelizë të organizmit të madh shoqëror kombëtar që përpunon e përhap normën letrare. Të gjitha këto, së bashku me lëvizjet e kontaktet e dendura të popullsisë midis rretheve e qyteteve që në krahasim me paraçlirimin sot pothuajse janë katërqindfishuar, ua kanë shkukur rrënjët veçimit krahinor e kontradiktave ndër-krahinore të trashëguara nga e kaluara, i kanë shpërthyer grupimet e mbyllura etnografiko-historike që ruanin mjaft mbeturina të strukturës shoqërore e të ideologjisë feudalo-patriarkale dhe që ushqenin, ndër të tjera, konceptet lokaliste e hegjemonizmin krahinor, dialektor dhe në

25) Shih «Disa tregues mbi zhvillimin ekonomik e shoqëror sipas rretheve», botim i Drejtorisë së statistikës, Tiranë, shtator 1972, f. 5.

fushën e gjuhës në dëm të përqëndrimit kombëtar. Kështu, revolucioni socialist e zgjeroi dhe e gjallëroi shumë bazën shoqërore, e cila, duke përçuar bashkëveprimin ndërdialektor, vendos, në fund të fundit, ritmet e normalizimit të gjuhës letrare e ndikon shumë edhe mbi vetë drejtimin e procesit normalizues.

c) Shprehësja themelore e përqëndrimit të përgjithshëm kombëtar dhe drejtuesja e tij është bërë sot Tirana, e cila vetëm pas çlirimit po luan në mënyrë të plotë, të gjithanshme e të mirëfilltë rolin e kryeqytetit. Pikërisht këtu është zhvilluar e zhvillohet në shkallën më të lartë edhe procesi i bashkëveprimi ndërdialektor. Duke lidhur e bashkërenduar në një tërësi të vetme veprimtarinë e të gjitha qendrave shoqërore e kulturore të vendit, kryeqyteti i Shqipërisë socialiste ka kryer e po kryen rolin e përpunuesit e të rrezatuesit kryesor të normës letrare të shqipes, duke ndikuar fuqimisht si rregullues i normalizimit të gjuhës së shkruar e të folur në shkallë kombëtare.

c) I gjithë ky zhvillim përcaktoi vetë thelbin e politikës gjuhësore të shoqërisë sonë, e cila e ka parë dhe e sheh kristalizimin e një gjuhe të përbashkët letrare si një çështje të madhe kombëtare. Çdo etapë, siç e pamë, ka pasur një politikë të vetën gjuhësore. Para çlirimit politika gjuhësore e shoqërisë shqiptare vuante nga kontradikta të thella, më mirë të themi, kishte dy politika gjuhësore — konvergjente dhe divergjente. Që në vitet e para pas çlirimit shkaqet kryesore shoqërore nga buronin këto kontradikta u zhdukën. Por vetë kontradikta objektive e trashëguar nga e kaluara, d.m.th. mospajtimi midis njësisë së kombit e të shtetit kombëtar shqiptar dhe dysisë së formës së gjuhës letrare, mbeti. Synimi për zhdukjen e saj, që ishte një prirje objektive e gjuhës sonë letrare që nga Rilindja, udhëhoqi edhe politikën gjuhësore aktive të shoqërisë sonë. Duke u nisur nga interesat e përbashkëta të popullit tonë, nga qëllimi që gjuha letrare t'i shërbejë sa më mirë përparimit të përgjithshëm të shtetit tonë monolit socialist e rritjes kulturore të masave të gjera punonjëse, shoqëria jonë e re ka përkrahur dhe përkrah në mënyrë të vetëdijshme procesin konvergjent në sferën e gjuhës letrare kombëtare, duke ndihmuar kështu që kjo gjuhë të kalojë përfundimisht nga gjendja dyformëshe në një njësi njëformëshe. Rrugët kryesore, nëpërmjet të cilave shoqëria jonë e ka ndihmuar normalizimin e zhvillimin e gjuhës letrare kanë qenë e janë shkolla, botimet dhe përhapja e radios. Pa dyshim, ky ndikim ka pasur e ka karakter të vetëdijshëm dhe hyn në radhën e faktorëve subjektivë shoqërorë, d.m.th. jashtëgjuhësorë, që veprojnë mbi gjuhën letrare. Megjithatë shoqëria jonë, e udhëhequr nga botëkuptimi materialist historik, është përpjekur që ndikimi i saj subjektiv mbi gjuhën t'u përgjigjet vetë prirjeve objektive të zhvillimit të strukturës së saj. Përndryshe, ky ndikim nuk do ta lehtësonte, por do ta pengonte procesin gjuhësor. Pikërisht për këtë arsye shoqëria jonë menjëherë pas çlirimit e bëri çështjen e gjuhës letrare problemin themelor të gjuhësisë shqiptare. Ajo i vuri vetes si detyrë të zbulojë ligjet e prirjet objektive të evolucionit të gjuhës letrare, të cilat lidhen ngushtë me vetë zhvillimin e shoqërisë, me qëllim që të shpejtojë ritmet e veprimi të këtyre ligjeve në pajtim me kërkesat e zhvillimit shoqëror, në këtë ose atë hallkë edhe të parashikojë shkencërisht gjerësinë, drejtimet e rrjedhimet

e veprimit të këtyre ligjeve, por jo t'i ndryshojë, t'i asgjësojë ose t'i zëvendësojë këto ligje në mënyrë arbitrare, të krijojë ajo vetë ligje të reja. Vlera e çdo lëvizjeje gjuhësore dhe e çdo politike gjuhësore matet kurdoherë me rezultatet e tyre objektive, reale. Ritmet e larta të një-simit të normës letrare dhe lulëzimi i pashembëllt i gjuhës letrare në këta tridhjetëvjetët e fundit tregojnë se politika gjuhësore e shoqërisë sonë ka qenë e drejtë e shumë dobiprurëse. Në thelb, kontradikta midis shoqërisë dhe gjuhës letrare, që na e la si trashëgim e kaluara, mund të quhet sot e kapërcyer.

Analiza shkencore e sistemit të gjuhës sonë letrare të sotme, e në mënyrë të veçantë e trajtës së saj të shkruar, na jep të drejtë të plotë të themi se ne kemi tashmë një gjuhë të vetme letrare dhe jo disa variante letrare pak a shumë të barasvlershme. Norma e kësaj gjuhe letrare kombëtare, pra edhe norma drejtshkrimore, është formuar krahas me zvogëlimin dhe shuarjen e funksioneve shoqërore të varianteve letrare të mëparshme. Ajo po kristalizohet e po kodifikohet përfundimisht në ditët tona.

Cilat janë ato veçori themelore të gjuhës sonë të sotme që na lejojnë të bëjmë një pohim të tillë? Për t'i vlerësuar drejt ato, është e nevojshme të kemi parasysh se shkalla e zhvillimit të gjuhëve letrare kombëtare matet nga dy tipare themelore — së pari, nga karakteri ligjësor i normativitetit, sepse norma është nocion qendror për çdo gjuhë letrare kombëtare; së dyti, nga gjerësia e rrezes së veprimit të gjuhës letrare kombëtare në prirjen e saj për t'u bërë gjuhë e përbashkët e gjithë popullit.

Le t'i shohim këto dy tipare në një prerje horizontale, sinkronike të gjuhës së sotme letrare shqipe.

1. Është fare e qartë se kjo gjuhë ka krijuar tashmë një sistem të vetin, që i takon një rrafshi më të lartë se ish-variantet letrare e dialektet dhe funksionon si një sistem i pavarur e tërësor i një tipi të ri. Ai as nuk përputhet me sistemin e këtij ose të atij varianti letrar të mëparshëm, as nuk përfaqëson një shkrirje mekanike të varianteve letrare, por është një sintezë e re organike e elementeve të gjuhës shqipe, e krijuar historikisht nga zhvillimi i shoqërisë sonë. Kjo sintezë ndërtohet, në radhë të parë, si një sintezë nënsistemesh a nivelesh, siç janë fonetika, gramatika, leksiku e fjalëformimi, që funksionojnë e zhvillohen si nënsisteme të ndërlidhura e të ndërvarura. Në të gjitha këto nënsisteme, sidomos në gjuhën e shkruar, sot mbizotërojnë ose zotërojnë plotësisht modelet e njësuarra a të normalizuara. Rastet e pastandardizuara ndër modelet produktive janë relativisht të pakta dhe paraqiten jo me mundësi të shumta zgjidhjeje, por vetëm si *dublete normative*. Pikërisht në një sferë të tillë të ngushtë, që në fund të fundit, përfshihet edhe ajo në rrethin e normës potenciale tashmë pak a shumë të përvijuar, zhvillohet tashti procesi i kristalizimit përfundimtar të strukturës gjuhësore normative. Të gjitha këto tregojnë se norma e gjuhës sonë letrare kombëtare sot ka një karakter të paktën po aqë ligjësor e të njësuar sa edhe në shumë gjuhë të tjera që problemin e normalizimit e quajnë të zgjidhur prej kohësh.

Në ç'raporte është sistemi i gjuhës sonë letrare kombëtare me ish-variantet letrare dhe me dialektet përkatëse?

Baza e këtij sistemi janë elementet e përbashkëta të shqipes, që i gjejmë në të dy dialektet. Ato kanë peshën specifike më të madhe në të gjitha nënsistemet e gjuhës letrare. Studimet e gjera dialektologjike pas çlirimit kanë treguar se elementet e përbashkëta në dy dialektet e shqipes janë më të shumta nga ç'mendohej në të kaluarën; janë pikërisht ato që kanë ruajtur ndër shekuj njësinë e gjuhës shqipe, duke mos lejuar, që të krijohej tek ne një diglosi a triglosi. Është vërtetuar kështu plotësisht pikëpamja që albanologu i njohur Holger Pedersen shprehu rreth gjysmë shekulli më parë: «Shumë herë është thënë — shkruante ai — se nuk ka njësi gjuhësore në Shqipëri, se të folmet e Veriut ndryshojnë krejt nga të folmet e Jugut, kështu që marrëveshja midis dy pjesëve të Shqipërisë është e pamundur. Por ky është një pohim krejt i rremë. Ndryshimi midis të dy dialekteve të gjuhës shqipe është shumë më i vogël se sa ndryshimet dialektore që vihen re në shumë gjuhë të tjera; nga pikëpamja praktike ndryshimi midis dialekteve të gjuhës shqipe nuk ka asnjë rëndësi»²⁶.

Krahas elementit të përbashkët mbizotërues në strukturën e shqipes së sotme letrare kanë hyrë edhe elemente me burim njëdialektor, të cilat përbëjnë disa tipare dalluese të dialekteve të shqipes. Këto elemente janë integruar në nënsistemet e ndryshme në përpjestime jo të njëjllota, janë bërë pjesë organike e këtyre nënsistemeve, duke hyrë në lidhje të reja midis tyre, gjë që nuk ndodh as në variantet letrare, as në dialektet, ku elementet dalluese e përjashtojnë fare njëri-tjetrin. Kështu, p.sh. struktura fonologjike e shqipes letrare tashmë është kristalizuar plotësisht me një përbërje prej 29 bashkëtingëlloresh e 7 zanorësh, të cilat në dritën e teorive të sotme mbi fonemat dhe alofonet mund të quhen fonema të përbashkëta të gjuhës shqipe që ekzistojnë në të folme të ndryshme të të dy dialekteve. Krahas këtij elementi të përbashkët, struktura fonetike e shqipes letrare kombëtare ka thithur edhe disa elemente dalluese të njërit a të tjetrit dialekt, siç janë sidomos mbizotërimi i rotacizmit, zotërimi i plotë i ë-së së theksuar në lidhje me mospranimin e zanores hundore (më, mëz, bëj, shallë etj. dhe jo mâ, mâz, bâj, shallâ etj.), mosasimilimi i togjeve të bashkëtingëlloreve mb, nd, ng, ngj (gjembi, vendi, kënga, ngjarje), vendosja tashmë e ngulët e fonemës rr (r e fortë) në sistemin fonologjik dhe zgjerimi i përdorimit të saj edhe jashtë kundërvënjeve fonematike krhs. p.sh. ruaj e ruaj dhe rrotë, rru-gë, rrufe, rrëmbej etj.), një prirje gjithnjë më e dukshme sidomos në brezat e rinj për mosshurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës (lab, breg, dredh, urov), etj. Por bie në sy se krahas rotacizmit, që është një fenomen tashmë i vdekur prej më se dhjetë shekujsh, shqipja e sotme letrare ka pranuar e vazhdon të pranojë edhe rorotacizmin verior që është një fenomen i gjallë dhe që në gjuhën letrare kombëtare vepron si antirotacizëm (bashkëjetojnë krahas zëri dhe zanore, krrerët dhe

26) Shih Holger Pedersen, «Gjuha shqipe» në rev. «Yll'i Mëngjezit» («The Morning star»), Boston Mass., 1917, Vol. 2, N. 8, f. 235 dhe Vol. 2, N. 6.

krenar, krenari, syri dhe synoj, rëra dhe ranishte etj.); po kështu bashkëjetojnë në një strukturë të vetme togu zanor ua me prejardhje jugore me togun ue — me prejardhje veriore (krhs. *punuat* dhe tokë e *punueshme, shoqëruar* dhe i *shoqërueshëm, pajtuar* dhe i *papajtueshëm, zbatuar e zbatues* etj.). Duke u kristalizuar në vijën e bashkëveprimit ndërdialektor, sistemi fonetik i shqipes së sotme letrare e ka thelluar edhe më tej një prirje shumë të rëndësishme që u duk e çeli rrugë që gjatë Rilindjes: — struktura fonetike, e marrë në kuptimin e saj më të gjerë, jo vetëm të mos e errësojë, por ta ruajë sa më të qartë strukturën morfologjike-fjalëformuese, pra edhe motivimin semantik të fjalës. Bashkëveprimi ndërdialektor ka pasur si rrjedhim që në strukturën fonetike të shqipes letrare kombëtare ndër elementet dalluese dialektore të mbizotërojnë ato të dialektit jugor, por edhe elementet dalluese të dialektit verior nuk janë të pakta (sipas një krahasimi të përafërt thjesht sasior raporti midis të parëve e të dytëve është 13 : 8)²⁷.

2) Një gjëndje pak a shumë e ngjashme vihet re edhe në strukturën morfologjike, ku pesha specifike e elementeve karakteristike të dialektit verior rritet deridiku jo vetëm si sasi, por edhe si cilësi. Nga kjo pikëpamje, rëndësi të veçantë kanë sidomos ngulitja e përemrit pronor i vet, e vet, të vet, prirja për zgjerimin e klasëve të emrave që e bëjnë shumësin me mbaresën -a, me sa duket, për një diferencim më të theksuar morfologjik të kundërvënjes njëjës-shumës, përhapja e tipit të shumësit tipik verior tek emra si *nip, stërnip, gisht, prind, viç* etj., sistemi paradigmor foljor, i cili në një pjesë të madhe ndërtohet duke pranuar spiranten -j dhe jo mbylltoren (okluziven) -nj: (krhs. *laj, të laj, do të laj, laja, do të laja, lakam* etj. dhe jo *lanj, të lanj, do të lanj, lanja o lanje, do të lanja o lanje, larëkam o lakërkam* etj.). Mund të themi se struktura morfologjike e shqipes së sotme letrare, së cilës i është dashur të bëjë një zgjedhje në masën e një morie të madhe trajtash, në përgjithësi sot është normalizuar në të dy boshtet kryesore — në paradigmën emërore e foljore. Lulatjet që vihen re më tepër në shumësin e emrave (sidomos përdorimi paralel i mbaresave zero /a, ë/a, e/a) e në rasën kallzore (përdorimi paralel i *njeriun* e *njerinë, kaun* e *kanë* etj.) ose përdorimi i barasvlershëm me *-s* e me *-t* i disa trajtave të foljeve me temë më *-t* (krhs. *shëtiti* e *shëtis, shëtite* e *shëtiste*, por *shëtitur, shëtitje* etj.) dhe lulatje të tjera të kësaj natyre përbëjnë dublete normative, që lidhen jo aq me moskristalizimin e normës, se sa me zhvillimin e mëtejshëm të normës.

3) Në strukturën fjalëformuese e leksikore të shqipes së sotme letrare, ku afëria e dialekteve është më e madhe se në fonetikë, elementet dalluese të njërit a të tjetrit dialekt janë gërshetuar në mënyrë pak a shumë të barasvlershme, qoftë nga ana sasiore, qoftë nga vlera cilësore. Leksiku dhe rrugët e mjetet e pasurimit të tij, që janë fusha ku bashkëveprimi ndërdialektor ka arritur shkallën më të lartë, janë bërë përcues të fuqishëm edhe për depërtimin e integrimin e veçorive fonetike e morfologjike të njërit a të tjetrit dialekt në strukturën e gjuhës letrare kombëtare. Fjala jo e përbashkët që ka thithur gjuha letrare nga ky ose


27) Pa dyshim vlera cilësore e këtyre elementeve nuk është e barabartë, por, sidoqoftë, edhe raporti sasior e tregon qartë prirjen e integrimin të elementeve dalluese të të dy dialekteve në një strukturë të vetme gjuhësore kombëtare.

ai variant letrar dialektor a dialekt, duke u bërë njësi e përbashkët e fjalorit letrar, ka sjellë me vete edhe tiparet dalluese fonetike e morfologjike, si edhe tipin a modelin fjalëformues. Këto tipare janë vënë në një përbashkim të drejtpërdrejtë edhe me *strukturën*, edhe me *sistemin* e gjuhës letrare në një fazë të caktuar të zhvillimit të tyre. Sistemi, si *tërësi e mundësive* strukturore të gjuhës letrare, është më i gjerë, ndërsa *strukture*, si *tërësi e mundësive të realizuara* është më e ngushtë dhe ka kufizimet e veta. Në këtë ose atë rast tiparet e veçanta që sjell me vete fjala, si kompleks i pandarë fonetiko-gramatikor e leksiko-semantik, i nënshtrohen strukturës, d.m.th. normës dhe asimilohen prej saj, por në raste të tjera, sidomos në kushtet e një konvergjence të fuqishme gjuhësore, si ajo e gjuhës sonë, për arsye gjuhësore e jashtëgjuhësore mund të mos i nënshtrohen strukturës, por i drejtohen sistemit, i cili ka qeliza të zbrazëta, mundësi ende të përealizuara. Duke realizuar ndonjërin nga këto mundësi, tiparet dalluese që vijnë me kalimin e fjalës në leksikon letrar integrohen në strukturën e gjuhës letrare dhe e zgjerojnë atë. Pikërisht kështu ka zënë vend në strukturën fonetike të shqipes letrare jorotacizmi, kështu janë zgjeruar tipet e nëntipet e shumësit më *-a* (krhs. *nxënës-it*, por *çelësat*) ose është bërë një risisistemim i tyre (krhs. p.sh. normën e sotme *prindët*, *nipat*, *stërnipat* e jo *prindërit*, *nipërit*, *stërnipërit*), kështu është pranuar nga gjuha letrare funksionimi paralel, me sa duket me prirje diferencimi semantik, i mbiemrave foljorë të tipit *i hapur* (tipar i arritur si pasojë e veprimit) dhe *i hapët* (tipar cilësor i vështruar shkëputurazi nga veprimi) ose përdorimi i gjerë i mbiemrave foljorë më *-shëm* (*i zbatueshëm*, *i pranueshëm*, *i tretshëm* etj.), ku tipari përcaktohet sipas aftësisë, vetisë, mundësisë për t'ju nënshtroar një veprimi etj. Në raste të tjera, pikërisht duke shfrytëzuar mundësitë e gjera të sistemit të shqipes, dy variantet dialektore në strukturën e gjuhës letrare janë sjellë në një emërues të përbashkët nëpërmjet një elementi (prapashtese etj.) që është i përbashkët për gjithë gjuhën. Kështu p.sh. në gjuhën letrare përdoren tashmë trajtat e përbashkëta të prapashtesave *-or*, *-tor*, në vend të trajtave të zberthyera dialektore jugore e veriore *-uar/-uer*, *-tuar/-tuer* (*lakror-i* dhe jo *lakruar* a *laknuer*, *uror-i* dhe jo *uruar* a *unuer*, *punëtor-i* dhe jo *punëtuar* a *punëtuer* etj.); po kështu kanë kaluar në trajtën e përbashkët letrare më *-tar* fjalët me prapashtesën dialektore *-tuer*: *harkëtar*, *lajkatar* etj. ashtu si *anëtar*, *pjesëtar* etj.). Të gjitha këto përfshihen sot në nocionin e normës letrare kombëtare. Nga kjo pikëpamje struktura e sotme e gjuhës sonë letrare është e hapët e do të mbetet e tillë. Përndryshe zhvillimi i gjuhës letrare do të ndërpritej. Ai që ne quajmë «kristalizimi përfundimtar i normës» në të vërtetë nuk është kurrë përfundimtar, i përjetshëm, statik; ai duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset.

Gjendjen e krijuar në gjuhën e sotme shqipe, të parë në prizmin e raportit midis normës dhe jonormës, mund ta përfytyronim në trajtën e dy rrahëve bashkëqendrorë (koncentrikë) me marrëdhënje hierarkike triplanëshe. *Rrethi i parë* (I) është rrethi strukturor *i normës* kombëtare të kristalizuar ose në kristalizim e sipër në hallka të veçanta. Ky është rrethi që qëndron në krye të shkallës së zhvillimit. *Rrethi i dytë*

është rrethi i *jonormës*. Ky rreth përbëhet nga dy nënndarje jo të një rrafshi, me marrëdhënje hierarkike. Nënndarja e parë (a) përfshin elementet e ish-varianteve letrare të ndërtuara mbi baza njëdialektore, që nuk janë pranuar në strukturën e gjuhës letrare kombëtare, kurse nënndarja e dytë (b) përfshin të gjithë truallin dialektor të shqipes së sotme që nuk kishte gjetur pasqyrim në asnjërin prej ish-varianteve letrare. Midis dy rrathëve vihen re marrëdhënje ndërveprimi e ndikimi të dyanshëm në drejtime të caktuara: midis rrethit të parë (normës kombëtare) dhe nënndarjes së parë (a) të rrethit të dytë ndërveprimi pothuajse ka përfunduar, sepse ish-variantet letrare mund të quhen tashmë të shuara, elementet thelbësore të tyre janë integruar në gjuhën letrare në përpjestime të ndryshme, kurse ato elemente që nuk janë integruar në të, kanë mbetur e do të mbeten përfundimisht, me ndonjë përjashtim të rrallë, jashtë rrethit të parë; ato kanë filluar të vlerësohen nga shoqëria e sotme si *nënstandarde (substandarde) krahinore* të gjuhës së shkruar dhe, në thelb, lidhen me nënndarjen b të rrethit të dytë, d.m.th. me dialektet si kategori mbeturinore. Një nënstandard i tillë pas çlirimit ka qëndruar më gjatë tek ne sidomos në fushën e poezisë, por ai sot është rrudhur dhe takohet shumë rrallë, për arsye se nga vetë këta shkrimtarë është kuptuar se mospërputhja midis përmbajtjes së gjërë kombëtare të krijimeve të tyre dhe formës gjuhësore të ngushtë, krahinore dëmton vetë përmbajtjen dhe se, siç është shprehur me të drejtë një nga historianët e sotëm të letërsisë sonë, «sa më shpejt përhapet gjuha letrare (kombëtare — A. K.), aq më shpejt vjen duke u vjetëruar gjuha e shkrimtarëve që shkruajnë në dialekte ose të folme»²⁸. Përkundrazi, ndërveprimi dhe ndikimi i dyanshëm midis normës dhe dialekteve (d.m.th. midis rrethit I dhe nënndarjes b të rrethit II) është shumë i gjallë dhe zhvillohet në të dyja drejtimet — nga I tek IIb dhe nga IIb tek I, d.m.th. gjuha letrare kombëtare ndikon mbi dialektet, duke shpejtuar procesin e shturrjes së tyre shkallëzore, dhe dialektet ndikojnë mbi gjuhën letrare, duke i sjellë asaj sidomos një pasurim në fushën e leksikut e të mjeteve fjalëformuese e duke ushtruar nëpërmjet tyre, një farë trysnie (presioni) edhe mbi nënsistemet e tjera, Ndikimi i drejtimit të parë (nga norma tek dialektet) bëhet çdo ditë më i fuqishëm e i gjithanshëm, kurse ndikimi i anasjelltë dobësohet e ngushtohet vazhdimisht. Vetë ndërveprimi midis dy dialekteve të shqipes bëhet sot kryesisht jo në vijë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet normës letrare kombëtare.

28) Shih Rexhep Qosja, *Përgjegjësia gjuhësore e shkrimtarit në «Kontinuitete»*, Prishtinë 1972, f. 188.



I = Gjuha letrare kombëtare e normalizuar.

II = Gjuha jo e normalizuar në shkallë kombëtare:

IIa = ish-variantet letrare me baza dialektore.

IIb = dialektet e sotme.

→ = ndikimi i gjuhës letrare mbi dialektet.


- - - → = ndikimi i dialekteve mbi gjuhën letrare.

⇨ = Shndërrimi i elementeve të varianteve letrare në elemente dialektore mbeturinore.

Kështu rrethi I është njëkohësisht edhe më i ngushtë, edhe më i gjerë se rrethi II: më i ngushtë, sepse as nga ish-variantet letrare, as nga dialektet nuk i ka marrë të gjitha elementet; më i gjerë, sepse ka krijuar shumë elemente të reja, qoftë materiale, qoftë në fushën e marrëdhënjeve brenda strukturës e sistemit të gjuhës letrare, të cilat nuk i kanë pasur as variantet letrare, as dialektet të marra veç e veç.

Edhe drejtimit e zhvillimit të këtyre dy rrathëve nuk përputhen, por janë të kundërta e aqë më tepër do të jenë të tilla këtej e tutje. Gjuha letrare (I) do të zhvillohet e do të lulëzojë gjithnjë më tepër. Përkundrazi dialektet janë tashmë një kategori mbeturinore e së kaluarës. Në kohën tonë, me krijimin e një gjuhe të vetme letrare e me ndryshimin rrënjësor të kushteve shoqërore, procesi i shturrjes së dialekteve është shpejtuar e në të ardhmen do të shpejtohet edhe më tepër. Kjo nuk do të thotë se dialektet do të shuhen menjëherë. Gjuha është një kategori shumë e qëndrueshme. Duke qenë në një proces të vazhdueshëm shturrjeje, dialektet do të vazhdojnë të bashkëjetojnë akoma për një kohë të gjatë me gjuhën letrare, si një formë mbeturinore, më e ulët, më e ngushtë e kumtimit *gojor* të shtresave të caktuara të popullsisë. Por mbi dialektet, si forma më e lartë e nivelit kombëtar, do të zotërojnë plotësisht në tërë veprimtarinë shoqërore, si në trajtën e shkruar, ashtu edhe në atë të folurën, gjuha letrare kombëtare. E tërë e ardhmja i takon kësaj.

Prerja horizontale e strukturës së gjuhës sonë letrare të sotme dëshmon se kjo nuk është ndërtuar mbi një bazë të ngushtë njëdialektore. Ndër të tjera, ajo tregon se mendimi i shfaqur më përpara se gjuha letrare e sotme është toskërishtja letrare, e ngritur drejtpërdrejt në shkallën kombëtare, nuk i përgjigjet së vërtetës shkencore. Nën sistemet e gjuhës letrare, të para në tërësinë e tyre komplekse, na lejojnë të arrijmë në përfundimin se gjuha letrare kombëtare shqipe është formuar e po përfundon kristalizimin e saj si *një koine letrare sui generis*, e cila ngërthen në strukturën e saj elementet themelore të përbashkëta të shqipes dhe elemente të rëndësishme dalluese të të dy dialekteve, të thithura nga ish-variantet letrare ose drejtpërdrejt nga dialektet në raporte herë të barasvlershme, herë jo të barasvlershme. Koinezimi i gjuhës sonë letrare kombëtare, pa dyshim, është bërë i mundshëm edhe nga afëria e madhe relative e dialekteve që nuk ka sjellë vështirësi praktike, edhe nga përputhja e vijës konvergjente në zhvillimin e shoqërisë e të gjuhës kombëtare, — vijë, e cila ka qenë thelbi i politikës gjuhësore të shoqërisë sonë socialiste. Kjo koine, nga pikëpamja e bazës dialektore, d.m.th. në raport me elementet dalluese me burim njëdialektor, mund të parafytyrohet në formën e një rrethi kombëtar (K) që mbulon pjesët kryesore të dy rrathëve dialektorë (V, J) me këtë ose atë ndryshim sasior (krhs. A dhe A₁), i cili nuk arrin asnjëherë t'i japë rrethit kombëtar një karakter njëdialektor as në bazën e tij, as në tërësinë e tij. Përkundrazi, rruga për të arritur te *makrokoineja* letrare kombëtare ka kaluar nëpër të dyja *mikrokoinetë* letrare shumë të afërta, që ishin gjithashtu dy forma të funksionimit letrar të një *makrokoineje* — të gjuhës së vetme të një kombi të vetëm.



- K = Gjuha letrare kombëtare e normalizuar.
 V = Varianti letrar verior dhe dialekti verior.
 J = Varianti letrar jugor dhe dialekti jugor.
 A, A₁ = elemente të varianteve letrare dialektore që nuk janë përfshirë në gjuhën letrare kombëtare.
 B, B₁ = elemente që janë krijuar në jetën e mëvetësishtme të gjuhës letrare, si sistem mbidialektor.

Dhe le të bëjmë tashti një krahasim midis modelit më të përsosur të koinesë letrare jugore të Rilindjes, poemës «*Bagëti e Bujqësia*» (1886) të Naim Frashërit dhe normës letrare të sotme:

«O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përpjetë,
 tëmer e frikë përhapni, përpini qiejt e retë!
 Të patundurë për jetë jini, pa, kur oshëtini,
 udhëtaritë në zëmrë frikë të madhe i vini.
 Kini shkëmbënj, gërxhe, lisa, lumënj dhe dëborë ndë gji,
 përsiprë lulez'e gjethe dhe brënda ergjënt e flori.
 E ju fusha bukuroshe edhe të majm' e pëllore,
 ju sheshet e lulëzuar, ju bregore gjelbërore,
 q'u fali Zoti të mira, u mba me shumë pekule,
 u dha bar e gjeth e veri, zoq e flutura e lule,
 zëmërn' e varfërë time aty ndër ju e kam mbluar:
 tek buron nga gjithi juaj uj'i ftoht' e i kulluar.
 Jam lark jush i dëshëruar edhe s'e duronj dot mallë,
 po s'e di, si dua unë — do t'u shoh një herë vallë!».

Në 14 vargje vihen re 24 raste ndryshimi nga norma e sotme. Dhe shumica e këtyre ndryshimeve janë përcaktuar nga përfshirja e elementeve të variantit letrar verior në normën e sotme o nga ndikimi i tyre i tërthortë.

Kjo veçori e gjuhës sonë letrare të sotme, e ka burimin që te Rilindja Kombëtare, por rolin vendimtar e kanë luajtur konvergjenca e fuqishme dhe bashkëveprimi ndër-dialektor i etapës së fundit, i cili

është bërë vija themelore e evolucionit të gjuhës letrare shqipe. Kjo vijë zhvillimi ka çuar në zgjidhjen përfundimtare të problemit të bazës dialektore të gjuhës letrare, i cili ka qenë problemi qendror i të gjitha diskutimeve rreth gjuhës letrare deri në vitet e para pas çlirimit. Tashti, me kodifikimin e normës së përbashkët, kanë dalë në plan të parë çështjet e kulturës së gjuhës, që lidhen drejtpërdrejt me përfundimin e me përsosjen e normës letrare kombëtare. Ky është një tregues tjetër i qartë se po fillon një fazë e re e etapës së tretë.

2. Gjerësia e rrezes së veprimit të gjuhës sonë letrare kombëtare përcaktohet në fund të fundit nga funksionet e saj shoqërore. Ne sot mund të flasim për dy përmasa të kësaj gjerësie — për sferat e veprimtarisë shoqërore që ngërthen ajo dhe për shtrirjen e saj në hapësirë, në gjirin e popullsisë që flet shqip.

Në aspektin e parë mund të themi se gjuha e sotme letrare shqipe kryen funksionet më të gjera që mund të kryejë një gjuhë kombëtare e zhvilluar: ajo përfshin të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore — është gjuha e shtetit, e ekonomisë dhe e politikës, e arësimit, e kulturës dhe e shkencës, gjuha e letërsisë artistike më të zhvilluar që ka pasur ndonjëherë populli shqiptar. Në këtë shumësi sferash janë përvijuar e shtresëzuar edhe stilet funksionale të gjuhës sonë letrare, në lidhje me të gjitha nënsistemet e saj. Këto stile, që po përpunohen çdo ditë e më mirë, kanë krijuar tashmë një sistem stilistikor mjaft të qartë, i cili u jep mjeteve gjuhësore mundësi të gjera përdorimi dhe gjuhës letrare në përgjithësi — aftësi të mëdha shprehjeje. Me zgjerimin e radhëve të mbartësve e të lëvruësve të gjuhës letrare në qytet e në fshat, kjo gjuhë është demokratizuar edhe më tej: duke ngërthyer me mijra fjalë e shprehje nga gurra popullore e të gjitha krahinave, që nuk i kishin variantet letrare të mëparshme, ajo i ka ngritur shumë më lart traditat e Rilindjes Kombëtare, është afruar më shumë me gjuhën e gjallë të popullit. Nga ana tjetër, duke përballuar detyrat gjithnjë më të mëdha për të shprehur edhe shkallën më të ngritur të përparimit të mendimit njerëzor në botën e sotme, për t'u shërbyer kërkesave të arësimit të lartë, të shkencës e të teknikës së përparuar, të kulturës socialiste në rritje të pandërprerë ajo edhe është intelektualizuar. Por edhe në këtë rrugë ajo ka ditur të ruajë lidhjet e saj të gjalla me gjuhën popullore, duke shfrytëzuar mundësitë reale e potenciale të kësaj gjuhe edhe për terminologjinë tekniko-shkencore më të specializuar, e cila, siç dihet është fusha ku gjuha letrare largohet më shumë nga gjuha popullore. Kështu, p.sh., në terminologjinë e sotme shkencore të arkitekturës termat e ndërtuar me mjetet produktive të shqipes përbëjnë rreth 68⁰/₀, në atë të botanikës — më se 65⁰/₀, në atë të akustikës — rreth 56⁰/₀, në atë të mekanikës — më se 51⁰/₀, në atë të optikës — rreth 50⁰/₀; bile edhe në terminologjinë e energjisë atomike ata arrijnë në më se 33⁰/₀²⁹. Dhe duhet thënë se gjuha

29. Shih përkatësisht: *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore*, 12; *Terminologjia e arkitekturës*, Tiranë, 1964; 1, *Terminologjia e botanikës*, Tiranë 1963; 6, *Terminologjia e akustikës*, Tiranë, 1963, 8, *Terminologjia e mekanikës*, Tiranës 1963; 5, *Terminologjia e optikës*, Tiranë 1963; 3, *Terminologjia e energjisë atomike*, Tiranë, 1963. Duhet thënë se shfrytëzimi i mundësive të gjuhës shqipe për terminologjinë tekniko-shkencore vjen gjithnjë duke u rritur.

e gjallë shqipe ka mundësi reale e potenciale akoma të pashfrytëzuara për ta rritur më tej peshën specifike të këtyre termave. Të gjitha këto dëshmojnë se shqipja letrare e kohës sonë ka marrë një karakter *polivalent* në kuptimin më të plotë të fjalës dhe se *polivalenca* e saj është bërë me të vërtetë *simetrike*.

Në aspektin e dytë, mund të themi se sot shqipja letrare e përbashkët përfshin pothuajse të gjitha popullsitë shqiptare brenda e jashtë Republikës Popullore të Shqipërisë dhe është bërë norma gjuhësore ideale për të gjithë ata që shkruajnë shqip. Ky është një hap i ri, cilësor në zgjerimin e funksioneve të saj kombëtare. Siç dihet, që prej disa vjetësh edhe nga shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi — në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, në të gjithë veprimtarinë shoqërore, arësimore, kulturore e shkencore ndër të tjera edhe në gjinitë e ndryshme të letërsisë artistike, përdoret pothuajse pa përjashtim gjuha letrare kombëtare shqipe e kohës sonë dhe drejtshkrimi i saj në bazë të vendimit të konsultës së gjerë shkencore të Prishtinës që u mblodh në prill të vitit 1968. Në këtë gjuhë të përbashkët tashmë është botuar atje një letërsi shumë e gjerë dhe e larmishme në të gjitha fushat, ndër të tjera edhe një shumicë veprash *poetike*, me vlerë artistike të shquar, gjë që dëshmon si për gjerësinë, ashtu edhe për thellësinë e përvetësimit të normës letrare kombëtare. Ky hap i rëndësishëm në historinë e gjuhës letrare shqipe mbështetet në kuptimin e drejtë shkencor të funksioneve historike e shoqërore të gjuhës letrare kombëtare, si edhe të raportit midis variantit letrar dialektor, si shprehje e një diapazoni kohësor e kulturor më të ngushtë e si kategori e një niveli më të ulët dhe gjuhës letrare kombëtare të njësuar si shprehja më e lartë e gjuhës së një kombi, e cila hap horizonte shumë më të gjera e të përparuara kulturore e botëkuptimore dhe u sjell brezave të sotëm e të ardhëm pasuritë e mëdha të traditës qindravjeçare gjuhësore-letrare të gjithë popullit tonë. Nga pikëpamja e vetë strukturës gjuhësore ky hap ishte rrjedhim i natyrshëm i ngritjes në një shkallë më të lartë të konvergjencës në fushën e gjuhës letrare, e cila është shprehur tek të gjitha botimet shqipe të atjeshme. Në këto botime nuk është përdorur asnjëherë një gjuhë e shkruar mbi bazën e ngushtë të të folmeve verilindore të shqipes, por është përdorur varianti letrar verior i mesëm, i cili përputhej me satarisht në masën 80-85% me strukturën fonetiko-gramatikore e leksikore të shqipes letrare të përbashkët dhe kishte prirje të qarta konvergjente, qendërsynuese³⁰. Kjo rrugë zhvillimi gjeti shprehjen e saj të kodifikuar edhe në «*Ortografinë e gjuhës shqipe*», që u botua në Prishtinë më 1964, vepër që ndihmoi për të kaluar më vonë në një

30) Krhs. p.sh. një vjershë, të nxjerrë nga vëllimi *Jehona e kohës* i Mark Krasniqit (Prishtinë, 1972) dhe dy fragmente tipike, të nxjerra nga romani i shkrimtarit Hivzi Sulejmani *Njerzit* (bot. Prishtinë, 1966):

- a) «Po thahet bari, dushku po *bjen*,
Luleve era *ma* nuk u vjen,
Dhe tokës mbarë po i ndrrohet fytyra,
Duket se ngadalë po vdes natyra.
Po ftohet dhe dielli e s'po rrezon,
Qielli po qan — shi të ftohtë rigon.

drejtshkrim të njësuar³¹. Pa dyshim, një shtrirje e tillë e mëtejshme hapësinore e funksioneve të shqipes letrare të përbashkët, që në thelbin e vet është një shtrirje e funksioneve të saj shoqërore, sjell një kontribut të ri edhe për njësimin, zhvillimin e pasurimin e mëtejshëm të saj, sepse e zgjeron mjaft rrethin e mbartësve e të përpunuesve të saj.

Synimi për të përdorur një gjuhë letrare të përbashkët ka çelur rrugë të mëtejshme edhe në diasporën shqiptare. Ai, mund të themi, është shndërruar në një lëvizje të vërtetë gjuhësore në kohën tonë. Në këta 10-15 vjetët e fundit kjo lëvizje ka ardhur duke u gjallëruar dhe e ka bërë gjithnjë më të qartë në vetëdijen e intelektualëve arbëreshë nevojën e përvetësimit të gjuhës letrare kombëtare. «Duhet të jetë detyrë nxitëse, e ngutshme e çdo shkrimtari arbëresh — shkruante kohët e fundit revista kulturore-shkencore «Zëri i Arbëreshvet» — të mësojë e të njohë mirë para së gjithash gramatikën e leksikun e Shqipërisë e atë arbëresh dhe pastaj të vihet të shkruajë në një gjuhë të përpunuar letrare, sa më të pastër, për t'u kuptuar kështu nga të gjithë shqiptarët e përndarë nëpër botë; vetëm me këtë kusht ai mund të quhet *shkrimtar* shqiptar. Duke vepruar në këtë mënyrë jo vetëm do të jepet një kontribut për gjuhën e letërsinë e përbashkët shqipe, por do të nxiten edhe arbëreshët e tjerë, sidomos të rinjtë, për të studiuar gjuhën tonë amtare, për ta folur e për ta shkruar atë bukur. Për fat të mirë, tashmë në këtë rrugë po ecën sot pjesa më e madhe e shkrimtarëve, të sotëm arbëreshë, sepse e kanë kuptuar se kjo është e vetmja rrugë, e

Shpezët e bukura të gjitha kanë *shkue*,
Bylbyli i vogël ka *fluturue*;
Edhe *dallëndyshat* e kanë *lanë* çerdhen,
Se ditë të vështira dhe për to erdhën.
Shkretë kanë *mbetë* malet, pa *kangë*, pa *gëzim*,
Vjeshta ka *zbritë* dhe në shpirtin tim...

(«Vjeshta», Prizren, 1940)

b) «Xhemilja herë punonte diçka te magja, *zjarmi* dhe enët, herë i *lente* të gjitha dhe ashtu me miell e me lot në sy u afrohej fëmijve dhe i pyette për gjithçka, për imtësitë *ma* të vogla, që *ma* në fund ta zgjatte dorën me miell dhe t'u lëmonte flokët. Ajo sot ishte shumë e *gëzue*. Gëzimin, të cilin s'e kishte *ndie kahe*rë, sot, *qe*, u *lëshue* si rrekeja. Kjo mbasditen e kaloi kështu. E kur u *ba* gati darka, u ul ndërmjet *tyne*, *tue ndie* *nji lumtuni* të pafundshme që i kishin *ardhë* *ma* në fund e përgjithmonë. I dukej se kishin qenë *dikund* larg. Diku shumë larg në vende të *hueja*. E *tash*, mbas brengës shumëvjeçare, ata, *që*, ishin aty. Aty pranë saj. Përgjithmonë». (f. 46).

c) «Agoi drita e kthjelltë. *Nji* prej *atyne* ditëve të para të bukura pranverore. Me rrezet e para të gëzueshme të diellit, bota gufoi nëpër rrugët e qytetit. *Mësyente* prej të gjitha anëve dhe *barte* flamuj, transparente, afishe... *Shtëpijat* stoliseshin. Në dritare dhe ballkone vareshin flamujt, qylymat dhe blerimi... Vajzat i *stolisshin* njerzit me lule. Thuese ishte *ndonji* festë e madhe popullore» (f. 124).

Siç shihet te «Vjeshta» njësitë që përputhen në të gjitha aspektet me gjuhën letrare të përbashkët arrijnë në rreth 88%, në fragmentin e parë të romanit — në rreth 83% dhe në të dytin — në rreth 85% (në tekst janë nënvizuar elementet dalluese). Ka edhe raste, ku kjo përputhje arrin deri në 90-92%.

31) Shih *Ortografija e gjuhës shqipe*, hartuar nga I. Ajeti (Kryetar i Komisionit hartues), P. Janura, S. Drini, H. Vokshi, M. Bardhi, L. Mulaku, M. Isaku, Kh. Gega dhe L. Lucaj; bot. Prishtinë, 1964.

pazëvendësueshme... Në fund të fundit... ky është përfundimi ku arrijnë të gjitha gjuhët, kur duhet të marrin një formë serioze kristalizimi e gjallërie... Dhe për t'u bindur më mirë për këtë, mjafton të hedhim një vështrim te Shqipëria e sotme, ku po mbyllet faza e fundit e procesit të evolucionit të gjuhës letrare... Le të zbatojmë, pra, edhe ne në shkrim rregullat gramatikore të Shqipërisë dhe përsa i përket leksikut të përdorim me kujdes trashëgimin tonë leksikor thjesht arbëresh dhe ta pasurojmë atë me fjalë të nxjerra nga fjalorët më të mirë të atdheut prej nga kemi ardhur»³².

Kështu shqipja letrare kombëtare, e cila ka përqëndruar vlerat më të mira gjuhësore të popullit tonë që janë ruajtur e janë rritur ndër shekuj, po e mbledh «gjakun e shprishur t'Arbërit» në një njësi gjuhësore të një tipi të ri, në epokën e zhvillimit më të lartë që kanë arritur deri më sot shqiptarët në historinë e tyre.

Kjo rrugë e ndërlikuar e formimit të shqipes letrare që nis në një periudhë kur mungon shteti kombëtar, zhvillohet në kushtet e një strukture shoqërore feudoborgjeze dhe arrin nivelin e kristalizimit të normës letrare kombëtare në epokën e ndërtimit të socializmit, e pasuron historinë e teorinë e përgjithshme të gjuhëve letrare me elemente të reja e origjinale.

II.

Njohja e veçorive të kristalizimit të gjuhës sonë letrare na jep mundësi të kuptojmë edhe tiparet e drejtshkrimit tonë të sotëm, edhe detyrat që dalin për njësimin e për përmirësimin e tij të mëtejshëm. Është pikërisht arritja e një kristalizimi të përgjithshëm në nënsistemet e ndryshme të gjuhës letrare dhe funksionet e saj të gjera shoqërore që kanë bërë edhe të domosdoshëm, edhe plotësisht të mundshëm njësimin e drejtshkrimit.

Drejtshkrimi, siç dihet, është një sistem rregullash për të shkruar drejt e njësoj po të njëjtat fjalë dhe trajtat e tyre gramatikore, për përdorimin e shkronjave të mëdha si edhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit. Ky sistem rregullash ka një pavarësi të caktuar më të madhe a më të vogël, ka në këtë ose atë masë edhe karakter konvencional, por ai, në fund të fundit, nuk është i shkëputur nga sistemi i përgjithshëm i gjuhës letrare dhe nga kërkesat e funksioneve të saj. Mund të thoshim që drejtshkrimi, nga kjo pikëpamje, hyn së pari në një mikrosistem trihallkësh, ku bashkë me të hyjnë edhe alfabeti, si tërësi e shkronjave të vendosura në një rend të caktuar dhe grafika si tërësi e raporteve midis shkronjave e tingujve. Të trija këto hallka plotësojnë njëra-tjetrën dhe bashkëveprimi i tyre synon të krijojë një sistem të harmonishëm shkrimi. Grafika dhe alfabeti i vënë caqe të mbyllura drejtshkrimit, sepse e detyrojnë që për këtë ose atë ortogram të zgjedhë një nga mundësitë që lejohen prej tyre. Këtu e kanë burimin kontradiktat midis alfabetit, grafikës dhe drejtshkrimit, të cilat ky i kapërcen tërësisht a pjesërisht me mundësitë që i jep sistemi i vet.

³²) Shih Emanuele Giordano, *Come scrivere in albanese*, rev. «Zëri i Arbëreshvet», 1972, I, f. 19.

Nga ana tjetër, i gjithë ky mikrosistem është krijuar e ka ndryshuar historikisht në lidhje të drejtpërdrejtë o të tërthortë me strukturën fonetiko-gramatikore, fjalëformuese e leksikore të gjuhës, është mbështetur e mbështetet tek ai dhe i ka shërbyer e i shërben funksionimit të tij, si edhe përsosjes së mëtejshme.

Një fat i përbashkët e ka lidhur drejtshkrimin e shqipes me alfabetin e me grafikën që nga shekulli XVI. Që prej atëhere u përdorën shumë alfabete e shumë mënyra shkrimi. Në njerën anë, lëvruesit e shqipes u përpoqën ta zgjidhnin problemin e shkrimit, duke u mbështetur në alfabetet e gjuhëve të tjera — në atë latin, grek, turko-arab e sllav. Në anën tjetër, si shprehje e rritjes së vetëdijes së kombësisë u krijuan në shekullin XVIII e në gjysmën e parë të shek. XIX edhe disa alfabete me tipare origjinale. Këto dy rrugë janë një nga karakteristikat dalluese të periudhës parakombëtare të shqipes së shkruar. Ato nuk ishin vetëm pasqyrim i pikëpamjeve a i prirjeve filologjike, por ndërthurreshin me koncepte ideologjike-kulturore e politike. Rilindja i dha lëvizjes për alfabetin një përmbajtje të re e një synim të qartë kombëtar-njësimit i alfabetit të ishte hapi i parë i vetëdijshëm për t'i dhënë shqipes së shkruar një fytyrë të vetme. Kjo kthesë filloi sidomos në vitet '60 të shekullit të kaluar, kur veprimtarë të shquar të Rilindjes si K. Kristoforidhi, J. Vreto, Pashko Vasa, Ismail Qemali, Hasan Tahsini e të tjerë, në mbledhjet e zjarra e të fshehta në një shtëpi të Stambollit, filluan «të mendoheshin bashkërisht për shkrimin e gjuhës së tyre», duke e ndjerë thellë «nevojën e përdorimit të një alfabeti të vetëm e të përbashkët, i cili të ketë aq shkronja të thjeshta një-trajtëshe sa tinguj të thjeshtë e të pandarë ka gjuha jonë shqipe»³³. Kësaj kërkesë ju përgjegy alfabeti i «Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip» i përpunuar nga Sami Frashëri. Tek ai janë gërshetuar qëllimet e rilindësve me kërkesat e rrepta shkencore, që janë fryt sidomos i njohurive të thella shkencore të Sami Frashërit, i cili, siç e tregojnë të gjitha veprat e tij, e në radhë të parë «Gjuha» («Lisan») dhe «Shkronjëto e gjuhësë shqip» (1886), i njihte edhe konceptet kryesore të gjuhësisë historike-krahasuese të shek. XIX. Pikërisht kjo zgjidhje e rreptë shkencore e bëri alfabetin e Stambollit bazën e alfabetit të sotëm, sepse që atëherë u caktua drejt raporti midis shkronjave e tingujve të shqipes, domethënë u hodhën themelet e përcaktimit të sistemit grafik e fonologjik të gjuhës sonë kombëtare. Kjo i çeli rrugën Kongresit të Manastirit (1908) dhe e lehtësoi detyrën e tij nga pikëpamja shkencore: tashmë, në thelb, përmbajtja fonologjike e alfabetit ishte zgjidhur, nga moria kaotike e fonemave dhe e varianteve të tyre në dialektet e të folmet e shqipes ishin zgjedhur shtatë zanore e 29 bashkëtingëllore dhe mbetej për t'u caktuar për to një trajtë e vetme grafike për gjithë shqiptarët. Prandaj, mund të themi se Samiu, me veprën e tij shkencore, ishte i pranishëm edhe në Kongresin e Manastirit. Ky Kongres, i frymëzuar nga idetë e mëdha të Rilindjes bëri, një sintezë të tre alfabeve të mëparshme — të atij të Stambollit, të alfabeve thjesht latine e të alfabetit të De Radës.

33) Shih Jani Vreto, *Mendime për shkrimin e gjuhës shqipe*, dorëshkrim në Arkivin e Shtetit, f. 103-105.

Kjo sintezë ishte shprehje e konvergjencës gjuhësore e politiko-kulturore. Pasqyrim i po këtyre synimeve të bashkimit kombëtar ishte edhe vetë kompromisi që bëri Kongresi i Manastirit, duke pranuar dy alfabetet — atë të Stambollit dhe atë që kemi sot. Megjithkëtë, Kongresi i Manastirit ka hyrë në historinë e kulturës sonë si kongresi që vendosi njësimin e alfabetit. A është i drejtë ky vlerësim, kur dihet se ai la në fuqi *dy alfabetet* «që të mësohen e të përdoren bashkarisht në mest të Shqypëtarëve» dhe që «mësimi ndë shkolla... të jetë i shtrënguar e i detyrëshëm për të dyja»?³⁴. Kësaj pyetjeje mund t'i japim një përgjigje të drejtë shkencore vetëm po të largohemi nga formulat e jashtme, nga shkronja e të shohim thelbin e çështjes, duke zbrëthyer si rrethanat historike që përcaktuan, Vendimin e Kongresit të Manastirit, ashtu edhe pasojat objektive të këtij Vendimi. Është e vërtetë se në të pranohen me të drejta të barabarta dy alfabetet. Dhe jo vetëm kaq. Alfabeti i Stambollit vihet në radhë të parë dhe vetë teksti i Vendimit është shkruar me këtë alfabet. Por, megjithkëtë, Kongresi i Manastirit ishte, si të themi, kënga e mjellmes për alfabetin e Stambollit. Ai edhe e pranoi, edhe e mohoi këtë alfabet. E pranoi në mënyrë eksplicite, duke e lënë shprehimisht në fuqi. E mohoi në mënyrë implicite, duke i kundërvënë, me të drejtat e barabarta të një alfabeti kombëtar, një alfabet tjetër që përfshinte plot dy të tretat e alfabetit të Stambollit dhe që kishte kundërshtim të disa epërsi cilësore e praktike. Ky alfabet i ri, d.m.th. alfabeti ynë i sotëm, vërtet ishte një hap prapa në krahasim me atë të Stambollit, përse i përket zbatimit të parimit «një shkronjë e thjeshtë për çdo tingull-fonemë», sepse ai pranoi dyshkronjëshat (digramet) për nëntë bashkëtingëllore dhe krijoi kështu për një varg shkronjash (d, j, g, h, l, n, r, s, t, z, x) vlera të dyfishta — një vlerë të pavarur dhe një tjetër të lidhur, të varur. Kjo e mëtej krijoi atëhere e krijon edhe sot për drejtshkrimin një problem që nuk do ta kishte, po të mos ishin pranuar digramet. Por, nga ana tjetër, alfabeti i ri ia kalonte atij të Stambollit në disa aspekte. Së pari, ai ishte një alfabet homogjen, vetëm me shkronja latine, pra ishte më i thjeshtë nga cilësia grafike, ndërsa ai i Stambollit ishte hibrid, heterogjen, pra edhe më i ndërlikuar grafikisht. Së dyti, ai ishte më i thjeshtë edhe nga pikëpamja sasimore, sepse kishte vetëm 27 shkronja-monograme, me të cilat krijonte edhe digramet, ndërsa ai i Stambollit kishte 36 monograme, me burim nga sisteme grafike të ndryshme. Së treti, teknikisht alfabeti thjesht latin i kishte mundësitë të përdorej për botimet shqipe menjëherë, në të gjitha shtypshkronjat, brenda e jashtë Shqipërisë, ndërsa ai i Stambollit kërkonte shtypshkronja me gërma të posaçme, vetëm për shqipen. Dhe kjo kishte rëndësi vendimtare në një kohë që botimet shqipe luanin një rol të dorës së parë në lëvizjen e madhe të çlirimit të kombit, të krijimit e të mbrojtjes së shtetit kombëtar. Kështu, Kongresi i Manastirit, në të vërtetë, i çeli rrugën një alfabeti të vetëm, i cili përmbledhte, në përgjithësi, disa nga cilësitë

34) Shih *Vendimi i Komisionit mbi çështjen e Abëcësë*, në gaz. «Lirija», Selanik, 8 vjeshtë 3-të, 1908, Nr. 15, f. 3 dhe në «Diturija», Selanik, 1 mars 1909, Nr. 3, f. 40.

më të mira të alfabeve të mëparshme. Po ta vlerësojmë në tërësi alfabetin e ri të Kongresit të Manastirit, në dritën e të gjitha këtyre epërsive e të rrethanave politiko-shoqërore e kulturore të asaj kohe, që Vendimi i Komisionit i quan «disa shkake të përjashtme», mund të themi se ai ishte një hap i madh përpara në vendosjen e sistemit grafik të shqipes letrare. Dhe kjo u vërtetua plotësisht nga vetë jeta: brenda pak vjetëve pas Kongresit të Manastirit ai u bë i vetmi alfabet kombëtar dhe vetë akti i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912 u shkrua me këtë alfabet.

Vendosja e një alfabeti të vetëm e mbylli odisenë e alfabeve të shqipes. Ky njësim i shërbeu «si përparimit të gjuhës, si të përhapurit të diturisë ndër ne»³⁵. Në krahasim me të kaluarën, ai i afrooi aq shumë të dy variantet letrare në shkrim, sa që nga albanologët më të shquar të kohës u vlerësua si një hap i barabartë edhe me vendosjen e një drejtshkrimi të njëjtë³⁶. Por ky përfundim i studjuesve të shqipes ishte i drejtë vetëm në krahasim me të kaluarën. Odiseja e drejtshkrimit të shqipes do të vazhdonte edhe disa dhjetëvjeçarë pas Kongresit të Manastirit, sepse drejtshkrimi nuk mund të njësohet pa u njësuar vetë struktura e gjuhës letrare. Dhe nuk është e rastit që Komisia Letrare e Shkodrës (1916-1917), e cila arriti të kodifikonte rezultatet kryesore të konvergjencës gjuhësore të Rilindjes e të zbatimit të alfabetit të njëjtë, çështjet e drejtshkrimit i trajtoi si pjesë përbërëse të problemit të madh të gjuhës letrare kombëtare. Komisia Letrare e Shkodrës ishte përmbushja e dëshirës së shprehur nga Kongresi i Manastirit që pas dy vjetësh të mbahej edhe një kongres tjetër «për orthografi e letraturë të gjuhës shqipe». Në luftë me pikëpamjet e ngushta lokaliste-klerikale dhe me presionet e të huajve, forcat demokratike e përparimtare të përfaqësuara në gjirin e Komisionit Letrare nga Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci, etj. i bënë vendimet e saj një gur themeli për njësimin e drejtshkrimit të shqipes pas Kongresit të Manastirit. Ata e konkretizuan dhe e çuan më tej në drejtshkrim vijën e Rilindjes që shkrimi i shqipes t'i shërbente ngulitjes së më të qartë të strukturës së fjalës dhe, mbi këtë bazë, të ruhej sa më shumë e përbashkëta, ajo që i afronte dialektet e variantet letrare dhe jo ajo që i dallonte e i largonte. Pikërisht për këtë arsye në vendimet e Komisionit Letrare, e cila shpalli si parim themelor që «orthografija e gjuhës të jetë, për sa të mundet fonetike» dhe që si bazë për të të merrej «dialekti i Elbasanit me disa përmirësime»³⁷, vetë «përmirësimet», që përfshinin edhe zbatimin e parimit morfologjik («etymologjik»),

35) Kështu përcaktohet në Vendimin e Kongresit të Manastirit qëllimi i një alfabeti të përbashkët.

36) «Thuhet se gjuha shqipe nuk ka ortografi të vendosur — shkruante Holger Pedersen më 1917. Kjo ishte e vërtetë dhjetë vjet më parë; po që nga Kongresi i Manastirit i 1908-ës, kjo deklaratë është një anakronizëm: ortografia e gjuhës shqipe është gjithaqë mirë vendosur sa edhe çdo tjetër ortografi.

Shih Holger Pedersen, *Gjuha shqipe* në rev. «Yll'i Mëngjezit» («The Morning Star»), Boston Mass., 1917, Vol. 2, N. 8, f. 235 (shih edhe botimin anglisht, Vol. 2, N. 6, f. 166).

37) Shih botimin e vendimeve të Komisionit Letrare në gaz. «Posta e Shqypnis», 1917, I, Nr. 95, § 1.

prekën disa hallka thelbësore dhe i kapërcyen caqet e ngushta të parimit fonetik të mbështetur në të folmen e Elbasanit. Këto hallka themelore janë:

a) në fushën e vokalizmit: ruajtja në shkrim e ë-së së patheksuar, «aty ku e lypë etymologjija e ku shqyptohet në tosknishte»³⁸, në trup të fjalës (*shëndet, shtëpi, rrëfye, këndue, etj.*), në fund të fjalës (*punë, mollë, lopë, luginë, gjarpnushë, burrë, djalë, gjalpë, i butë, i mirë, i shpejtë, i shëndoshë etj.*; tek shumësi: *puntorë, kryetarë*; tek foljet: *shkojmë, bájme, thashtë, bleftë*; tek nyjat të, së, tek parafjalët *mbë, ndë*); mospasqyrimi në drejtshkrim i kuantitetit të zanoreve që përbën një karakteristikë dalluese kryesisht të të folmeve veriore, gjë që e përforcoi edhe më tepër ruajtjen e ë-së, sepse, sipas vëzhgimeve tona, në të folmet veriore shumicën e fjalëve me zanore të gjata nuk e përbën grupi i fjalëve ku ato janë të hershme (si *dët, në, dy etj.*), por ai grup ku këto zanore janë rezultate relativisht të vona të ndryshimeve fonetike; në të pjesa më e madhe përfaqësohet nga ato fjalë, ku zgjatja e zanores është një kompensim i rënjes së ë-së fundore (si *būk, ūj, dōr, der, ān, pūn, kāl, flet, i būt, i mīr etj.*); shkrimi i plotë i diftongjeve ie, ye, ue (*qiell; krye; thue*); kufizimi i shenjës së zanoreve hundore, duke e lejuar atë vetëm në dy raste (*zâ, âsht* dhe *pê, frê, hî, mullî*).

b) në fushën e konsonantizmit; shkrimi e shqiptimi i paasimiluar i togjeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ngj, (nder, rend, mbret, ungjill)*, që përbën një nga dallimet kryesore midis dy dialekteve të shqipes.

Vendimet e Komisionit Letraro i afruan mjaft të dy variantet letrare në shkrim dhe, pasi u miratuan nga Kongresi Arësitor i Lushnjës më 1920, u bënë baza e drejtshkrimit të shqipes në vitet '20-'40 të shekullit tonë. Ato krijuan një traditë të qëndrueshme për disa ortograme të rëndësishme, ku variantet letrare dialektore dalloheshin. Këto ortograme kanë zënë vend edhe në drejtshkrimin e sotëm. Por, me gjithë afrimin, Komisioni sanksionoi dy drejtshkrime, si shprehës të dy varianteve letrare. Detyra për të krijuar një gjuhë letrare të njëzuar e një drejtshkrim të vetëm i mbeti epokës sonë.

Pas çlirimit të Shqipërisë drejtshkrimi, duke u parë gjithnjë si hallkë e pandarë e gjuhës letrare, u trajtua jo thjesht si çështje teorike, por, në radhë të parë, si çështje e ngutshme praktike. Këtë e kerkonte vetë zhvillimi i shoqërisë sonë, ku libri, fjala e shkruar u bënë përçuesit kryesorë të dijeve në masat e gjera të popullit. Historia e përpjekjeve të organizuara të institucioneve shkencore të vendit tonë, si edhe të shtresave të gjera të punonjësve të arësimit e të kulturës për zgjidhjen e problemit të drejtshkrimit pas çlirimit është shumë e pasur. Ajo është një treguese e qartë si e vetë evolucionit objektiv të gjuhës sonë letrare drejt njësimi, ashtu edhe e rritjes së shkencës gjuhësore shqiptare. Kjo përvojë historike, pa dyshim, meriton të studjohet veçanërisht në disa aspekte. Ne këtu do të kufizohemi në një vështrim të përmbledhur të kësaj rruge rreth tridhjetëvjeçare kërkimesh të pandërprera për një nga problemet më të ndërlikuara të normës së shqipes letrare. Duke u mbështetur në evolucionin e koncepteve teorike që përshkojnë kërkimet për drejtshkrimin dhe në mishërimin e

38) Po aty, § 2.

tyre në një varg botimesh për rregullat drejtshkrimore, këtë rrugë mund ta ndajmë në dy faza.

Faza e parë nis që nga çlirimi dhe arrin zhvillimin më të lartë me «Ortografinë e gjuhës shqipe» të botuar më 1956. Që në fillim të kësaj faze u përcaktuan vijat themelore për zgjidhjen teorike e praktike të problemit të drejtshkrimit — baza e tij të ishte struktura fonetike e shqipes, përdorimi më i përhapur i trajtavet morfologjike dhe afrimi i dy dialekteve³⁹. Drejtshkrimi u bë çështje e masave të arësimuara, që shtoheshin çdo ditë. Fryti i parë i rëndësishëm i këtyre përpjekjeve ishte botimi i «Ortografisë së gjuhës shqipe» më 1951 (hartuar nga A. Xhuvani, K. Cipo, E. Çabej), e cila në disa hallka e çoi më tej afrimin e dy varianteve letrare në shkrim pas Komisionit Letraro të Shkodrës. Pa dyshim, ky hap drejt njësitimit në atë kohë objektivisht nuk mund të ishte tepër i madh, sepse në mjaft raste, siç theksohet me të drejtë nga autorët e ortografisë së mësipërme, vetë gjuha nuk kishte marrë akoma një drejtim të caktuar, të ngulitur mirë⁴⁰. Kështu, kjo ortografi u paraqit si një ortografi e dy varianteve letrare dialektore në rrugën e afrimit. Krahas kësaj, kjo ortografi, megjithëse pranonte si bazë «fonetikën e gjuhës», ndërtohej kryesisht sipas pjesëve të ligjëratës që, siç dihet, janë kategori leksiko-gramatikore. Kështu, baza fonetike copëzohej.

Një sqarim të mëtejshëm të problemeve të drejtshkrimit solli Konferenca e Ortografisë më 1953, e cila i trajtoi këto probleme në mënyrë më të thelluar e në disa aspekte, duke u mbështetur edhe në përfundimet që u nxorën nga dy Konferencat kombëtare për gjuhën letrare shqipe më 1952. Konferenca e Ortografisë analizoi më qartë nevojën e gërshetimit të parimit themelor — të parimit fonetik, — me parimin morfologjik e me atë historik në raste të caktuara. Ajo ritheksoi, në dritën e prirjeve të deriatëhershme të procesit gjuhësor të pasçlirimit, synimin «që të shpihet më tutje procesi i njëzimit të ortografisë, duke ndjekur rrugën e afrimit të dialekteve e të folmeve», pa u shkëputur nga tradita e mëparshme letrare⁴¹. Ashtu si edhe në Konferencën kombëtare për gjuhën letrare në shtator të 1952-së, edhe në Konferencën e ortografisë u hodh ideja për të kaluar nga një drejtshkrim me dy variante në një të vetëm. Për këtë më vonë u bënë përpjekje jo të vogla dhe në «Orografinë e gjuhës shqipe» të 1956-ës (hartuar përfundimisht nga A. Xhuvani, E. Çabej, A. Kostallari, M. Domi), që konkretizoi e zhvilloi më tej kërkesat e Konferencës së 1953-së, zgjidhjet dyvariantëshe u pakësuan shumë. Ortografia e 1956-ës ishte një shkallë e re jo vetëm në rrugën e njësitimit të rregullave, por edhe në trajtimin e tyre në një kuadër më të gjerë dhe teorikisht më të lartë. Megjithatë, ajo e ruajti ndërtimin e ortografisë së 1951-së dhe vetëdijen se përbënte vetëm një shkallë kalimtare për një drejtshkrim përfundimtar.

39) Shih referatin e mbajtur nga A. Xhuvani mbi detyrat në fushën e studimeve gjuhësore e letrare, botuar në «Buletin i Institutit të Studimeve», 1947, 1.

40) Shih *Ortografia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1951, f. 4.

41) Shih referatin e M. Domit *Parimet dhe kriteret e ortografisë*, mbajtur në Konferencën e vitit 1953 (citohet sipas botimit të bërë nga J. Kastrati në «Buletin shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», 1970, 9, f. 104-105).

Kështu, faza e parë e shpuri shumë më tej njësimin e drejtshkrimit në krahasim me paraqirimin, por problemin në tërësinë e tij nuk e zgjidhi. Mbi të vazhdoi të rëndonte trysnia e dy varianteve letrare, që kërkonin dy drejtshkrime. Shkëputja nga kjo ide e nga kjo gjendje nuk ishte e lehtë. Ajo u bë dalëngadalë gjatë fazës së dytë nën ndikimin e dy faktorëve. Së pari, vetë gjuha letrare, me ritmet e saj të pashembëllta, i përcaktoi aty nga fundi i viteve '50 dhe në vitet '60 shumë më qartë prirjet themelore të zhvillimit të saj. Së dyti, gjuhësia jonë, duke përvetësuar gjerësisht metodologjinë marksiste, depërtoi gjithnjë më thellë në njohjen e strukturës së shqipes së sotme e të historisë së saj: disa nga problemet-nyje të gjuhës së sotme shqipe u bënë objekt analizash të hollësishme monografike, duke pasur si bosht qendror gjuhën letrare e normat e saj, filloi mbledhja ballësore e sistematike e leksikut dhe e frazeologjisë së shqipes së shkruar e të folur dhe studimi i rrugëve të pasurimit të tij, u krye hulumtimi i parë e i përgjithshëm i ndarjes dialektore të shqipes e i veçorive të të folmeve të ndryshme, filloi përpunimi e njësimi i terminologjisë tekniko-shkencore në fushat kryesore, u bënë studime të reja etimologjike, krahas studimeve në fushën e fonetikës historike, filloi edhe studimi eksperimental i veçorive të strukturës fonetike-fonologjike të gjuhës së sotme. Këto përpjekje shkencore çelën shpeshherë rrugë të reja: u rishikuan një varg tezash e konceptesh jo të drejta, të kapërcyera nga vetë koha; në luftë me një varg pikëpamjesh të ngushta e skeptike, që buronin nga një metodologji jo e saktë, u krijua një kuptim i drejtë i gjuhës letrare kombëtare e i normës letrare dhe u bënë përgjithësime e vlerësime të reja shkencore rreth procesit të formimit të shqipes letrare kombëtare. Të gjitha këto, në kushtet kur procesi i gjuhës letrare hyri gjerësisht në fazën e kristalizimit tërësor, dhanë mundësi që edhe në fushën e drejtshkrimit të bëhej një hap cilësor përpara — të vendosej një drejtshkrim i vetëm për një formë të vetme të gjuhës letrare. Ky hap ishin «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes» që u botuan si projekt në shkurt të vitit 1967.

Gjatë këtyre pesë-gjashtë vjetëve mund të themi se ky projekt i është nënshtruar një prove të dyfishtë — zbatimit në të gjitha botimet shqipe brenda e jashtë Shqipërisë dhe diskutimit shkencor e krijues më të gjerë që është bërë deri më sot për problemet e gjuhës shqipe. Kjo provë nxori në shesh vlerat e tij shkencore e praktike dhe të metat e tij.

Zbatimi i «Rregullave të drejtshkrimit» të 1967-ës vërtetoi se sot është plotësisht e mundshme të kemi një drejtshkrim të vetëm, i cili nuk qëndron si diçka e veçuar, e shkëputur si një veshje e gjerë, e parakohshme në trupin e gjuhës letrare, por u përgjigjet kërkesave të normës së sotme të kristalizuara o në kristalizim e sipër, si pjesë e saj organike, që e përforcon këtë normë. Lulatjet që vihen re në drejtshkrimin e sotëm nuk kanë të bëjnë me zgjidhjet themelore a me koncepte teorike të kundërta me ato që përbëjnë boshtin qendror teorik të tij, por lidhen ose me mospranimin e zgjidhjeve të veçanta ose me zotërimin e pamjaftueshëm të rregullave. Zbatimi i drejtshkrimit të 1967-ës në tekstet shkollorë e në të gjitha llojet e botimeve ka sjellë një rrafshim të përgjithshëm të ortogrameve, të shumë luhatjeve e të çështjeve drejtshkrimore që kishin mbetur për një kohë të gjatë si të diskutueshme. Ai veprimi si një mjet konkret për përvetësimin e normave të gju-

hës letrare nga masat e gjera dhe e bëri më të mprehtë sidomos nevojën e krijimit të një fronti të vetëm gjuhësor në shkollën tonë, i cili të udhëhiqet nga norma letrare e teksteve. Nga ana tjetër ai ka zbuluar edhe se ku drejtshkrimi i sotëm nuk i plotëson si duhet funksionet e tij, cilat rregulla duhen qartësuar e saktësuar, si duhet përmirësuar e plotësuar më tej ky drejtshkrim.

Diskutimi i gjerë shkencor brenda e jashtë Shqipërisë, siç dihet, i ka vlerësuar «Rregullat e drejtshkrimit» të 1967-ës si kodifikimin më të plotë e më sistematik të një norme të vetme drejtshkrimore të shqipës dhe si një nga arritjet kryesore të gjuhësisë së re shqiptare. Ai ka vënë në dukje nivelin shkencor të Projektit, që i përgjigjet nivelit të gjuhësisë së sotme më të përparuar, parimet e tij themelore të drejta e bazë objektive të zgjidhjeve, gjerësinë e vështrimit të problemeve, marrjen parasysh edhe të realitetit gjuhësor të sotëm edhe të prirjeve të zhvillimit të mëtejshëm të gjuhës letrare, mbështetjen tek gjuha e gjallë e popullit dhe tek vlerat më të mira të trashëgimit shkencor në fushën e albanologjisë e të traditës sonë letrare. Diskutimi popullor ka miratuar njëzëri edhe kriterin fonetik të ndërtimit të projektit, i cili e zhduk përfundimisht copëzimin e brendshëm të drejtshkrimeve të mëparshme.

Krahas kësaj, gjatë diskutimit popullor janë bërë edhe një varg vërejtjesh e sugjerimesh, janë ngritur mjaft çështje me rëndësi, zgjidhja e të cilave, pa dyshim, do të jetë një ndihmë e madhe për përmirësimin e plotësimin e Projektit dhe për hartimin përfundimtar të rregullave drejtshkrimore të shqipes. Këto vërejtje e sugjerime, të cilat pjesëmarrësit e këtij Kongresi i njohin mirë, prekin shumë zgjidhje e pika të veçanta të Projektit: — zberthimin e parimeve e të kriterëve udhëheqëse, si edhe përcaktimin më të mirë të sferave të veprimit të tyre, zgjidhjen më konsekuente të shkrimit të ë-së së patheksuar e të bashkëtingëlloreve nistore sh-/ç-/zh, shkrimin e j-së në disa raste të caktuara, takimin e bashkëtingëlloreve g e n me j-në, si edhe të d, s, t, z me h-në, përmirësimin e plotësimin e trajtimit të shkrimit të fjalëve bashkë ose ndaras, duke përfshirë këtu edhe një varg lokucionesh lidhëzore, para-fjalore etj. që krijojnë sot problem ortogrami, saktësimin e disa rregullave rreth përdorimit të shkronjave të mëdha, duke e zgjeruar njëkohësisht edhe gjithë trajtimin e këtij problemi, gjetjen e një zgjidhjeje më të lehtë e më të përvetësueshme për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, sistemimin më të mirë a plotësimin e lëndës që ka të bëjë me çështje gramatikore etj. Për të gjitha këto propozohen zgjidhje të ndryshme, që shpeshherë janë edhe të kundërta. Por ato të gjitha përshkohen nga disa kërkesa themelore: rregullat e drejtshkrimit të bëhen më të qarta e më të thjeshta, të ecet edhe më tej në rrugën e rrafshimit për hir të njësimin, duke hequr zgjidhjet dyfishe, më pak rregulla — me pak përjashtime. Në parim të gjitha këto kërkesa janë të drejta. Ato përputhen me cilësitë që duhet të ketë çdo kod i mirë drejtshkrimor e në mënyrë të veçantë kodi drejtshkrimor i shqipes së sotme letrare, e cila ka nevojë për një drejtshkrim aktiv, perspektiv, d.m.th. që ta ketë fytyrën të kthyer jo vetëm nga e kaluara, por edhe nga e ardhmja, të mishërojë edhe normën e kristalizuar, edhe prognozën shkencore të normës që po kristalizohet.

Të gjitha çështjet e mësipërme Kongresi ynë do t'i shqyrtojë m imtësi, me një rrahje të gjerë mendimesh. Ai do të thotë fjalën e tij t autoritetshme për zgjidhjen e tyre përfundimtare, duke u udhëhequ nga teoria materialiste mbi gjuhët letrare, nga veçoritë e formimit t shqipes letrare kombëtare dhe nga teoria drejtshkrimore në shkallën q ajo është përpunuar nga gjuhësia e sotme.

— Njësia-bazë për drejtshkrimin, ashtu si edhe për gjuhën është fjal — me kufijtë e me identitetin e saj, me lidhjet e saj të shumanshme. Është thënë me të drejtë se drejtshkrimi i fjalës është edhe jetëshkrim i fjalës. Ashtu sikurse jeta e veçantë e çdo fjale përcaktohet në fund të fundit, nga kategoritë e përgjithshme ku ajo bën pjesë, nga marrë dhëniet brenda një klase e nënsistemi të caktuar brenda sistemit tërësor të gjuhës, ashtu edhe ortogrami i çdo fjale, zgjidhja e kësaj ose e asa çështjeje të veçantë drejtshkrimore përcaktohet, në fund të fundit, nga tërësia e drejtshkrimit si sistem dhe nga marrëdhëniet midis hallkave të këtij sistemi. Ky sistem, i krijuar historikisht, ndërtohet sipas disa parimeve të caktuara e udhëhiqet prej tyre. Përcaktimi i drejtë shkencor i këtyre parimeve, i rolit të tyre në sistemin drejtshkrimor të shqipes pra, edhe i marrëdhënieve ndërmjet tyre, ka rëndësi vendimtare për t' vënë mbi një bazë të shëndoshë zgjidhjet e veçanta. Mbi të gjitha, ka rëndësi përcaktimi i parimit themelor. Si i tillë për drejtshkrimin e shqipes në Projektin e 1967-ës është vlerësuar parimi fonetik. Krahas tij është pranuar edhe parimi morfologjik. Vetë «Rregullat e drejtshkrimit» ndërtohen mbi dy boshte — mbi atë fonetik, në radhë të parë, dhe mbi atë morfologjik. Këto dy boshte në përgjithësi nuk i kundërvihen njëri-tjetrit, por kryqëzohen e bashkëveprojnë, duke synuar që drejtshkrimi të jetë sa më sistemor e i qëndrueshëm dhe sa më i thjeshtë.

— Gjatë diskutimit popullor është prekur edhe çështja e parimeve: parimi fonetik është pranuar përgjithësisht si themelori, por në disa raste janë shprehur edhe mendime për t'i dhënë epërsinë parimit morfologjik mbi atë fonetik në drejtshkrimin e sotëm ose për ta përkufizuar parimin fonetik si parim «fonematik».

Çështja e parimit themelor, pa dyshim, është më e rëndësishmja dhe njëkohësisht më e ndërlikuara, më e vështira për drejtshkrimin tonë. Ajo është pjesa përbërëse kryesore e teorisë drejtshkrimore, sepse përcaktimi i parimit udhëheqës e vë theksin logjik mbi hallkën vendimtare të sistemit të drejtshkrimit. Nga duhet të nisemi për të përcaktuar parimin themelor? Duke marrë parasysh se drejtshkrimi lidhet si me anën tingullore, ashtu edhe me anën kuptimore të gjuhës (me strukturën gramatikore e leksikore), mendojmë se është e domosdoshme të mbështetemi në dy kushte: të parin të shohim se cila është pesha specifike e shkrimeve sipas këtij ose atij parimi në tërësinë e leksikut të shqipes së sotme; së dyti, të marrim parasysh se cili parim zbatohet në rastet kur zgjidhja paraqitet me dy a më shumë mundësi, pra të shohim rrjedhimin e ndeshjes së dy a më shumë parimeve.

Për kushtin e parë na japin përgjigje të dhënat sasiore. Pas një analize që u kemi bërë në trajtat përfaqësuese 23.266 fjalëve që përfshin «Fjalori i gjuhës shqipe» (1954), duke zbatuar për to rregullat e drejtshkrimit të sotëm, na ka dalë kjo pasqyrë përsa i përket ndarjes së madhe në shkrime fonetike dhe shkrime jofonetike:

Parimi drejtshkrimor që zbatohet	Emra	Mbiemra	Përemra	Numërorë	Folje	Ndajfolje	Parafjalë	Lidhëza	Pasthirrma	Pjesëza	Fjalë të palakueshme	Gjithsej	Përqindja mbi leksikun tërësor
I. Fjalë që shkruhen plotësisht sipas parimit fonetik	10458	2765	71	4	3333	990	41	68	50	10	57	17847	76,7
II. Fjalë që shkruhen jo plotësisht sipas parimit fonetik, por që pjesërisht mund të lejojnë edhe interpretimin si ortograme fonetike	4256	723	17	27	173	193	7	11	2	1	9	5419	23,3

Në grupin I përfshihen:

emra si p.sh. *akull, armik, bar, bari, blerës, cak, cen, dalje, drejtori, disk, duartrokitje, elbore, endacak, epror, faj, fik, fjalim, flegër, gisht, grusht, gjak, gjë, helm, ikje, ilegal, jargavan, ka, kos, krap, kryeqytet, kumbullore, lajkatar, lek, lexim, liri, lule, llogore, makth, mal, mendim, minator, nallban, nder, njeri, oborr, orizore, parakalim, përpara, push, qafore, rilindje, rini, rrafsh, skaj, shakull, shkop, shpirt, shallë, tavan, thark, ushqim, vaj, xinxife, yll, zabel, zall, etj.;*

mbiemra si *ajror-e, analfabet-e, bardhosh-e, i(e) brengosur, i(e) çiltër, i(e) dashur, dinak-e, dyvjeçar-e, eshtak-e, fillestar-e, fushor-e, gojor-e, idealist-e, jugor-e, lakmitar, leshtor-e, malor-e, i neveritshëm, i njelmët, i(e) paepur, i pashëm, qesharak-e, i ri — e re, i(e) rrahur, sylesh-e, i(e) shtruar, trupor-e, thatanik-e, veror-e, zyrtar-e, zhelan-e etj.;*

folje si *acaroj, banoj, çelnikos, çoj, dal, dalloj, dhuroj, elektrifikoj, fal, faqos, gozhdoj, gjalloj, jap, kacafytem, lako, llogarit, marr, ndryshk, ngul, njoftoj, orvatem, pasqyroj, qep, rrok, sajoj, shkas, turrem, tërbom, thaj, vadit, xhindosem, ysht, zymtoj etj.;*

përemra si *ajo, ata, askush, ca, cili, dikush, ju, ndokush, secili, i(e) vet etj.;*

numërorë si *dyzet, katër, tre etj.;*

ndajfolje si *atje, aty, ashtu, befas, drejt, ende, fare, fluturimthi, gabimisht, gjithandej, kudo, lart, majtas, plot, pupthi, sivjet, sheshit, trokthi, veçan, vjedhurazi, xurxull, zakonisht, zhytas etj.;*

parafjalë si *deri, kundër, nga, prej, sipas etj.;*

lidhëza si *apo, bile, dhe, edhe, kurse, porsa, si, sikurse etj.;*

pasthirrma si *ah!, dale!, hej!, ore!, urra!, vaj! etj.;*

pjesëza si *duke, me, po etj.*

Në grupin II përfshihen:

a) fjalë me -ë paratheksore e me -ë fundore, të shqiptueshme me shkallë të ndryshme reduktimi, si p.sh. *mirësi, gjallëri, njerëzim, ndër-mjetësoj, shoqëroj* etj. ose *arë, banesë, bletë, fletë, daltë, dritë, dorë, fshe-së, gjuhë, kthesë, kordhë, mungesë, rrogë, shoshë, udhë, urë, verë, zanë, zorrë* etj.;

b) fjalë me bashkëtingëllore të zëshme, që mund t'i nënshtrohet shurdhimit si *breg, shteg, djeg, plumb, tund, njëqind, qengj, brez, rro-goz, urov* etj.

Siç shihet, parimi fonetik mbulon mbi 76% të fjalorit-bazë të shqi-pes, ndërsa sfera e veprimit të parimeve të tjera është shumë më e ngushtë — vetëm 23%. Pikërisht në këtë sferë vepron drejtpërdrejt parimi morfologjik ose bashkëvepron me parimin fonetik e me disa pa-rime të tjera si ai semantik, simbolik etj., që kanë një peshë specifike më të vogël. Ka rëndësi, gjithashtu, edhe fakti që në grupin e dytë 3808 fjalë, d.m.th. mbi 70% janë emra me -ë fundore, të cilët në shumicën e trajtave paradigmore shkruhen plotësisht sipas parimit fonetik, d.m.th. hyjnë në elementet e përbashkësisë relative të varianteve letrare (krhs. p.sh. *em., kallz, njëjës dritë, por drita, drite, dritën, drita-t, dritavet, dri-tash* etj.). Kjo e zgjeron edhe më tepër zbatimin e parimit fonetik.

Këtu e gjejmë të nevojshme të sqarojmë se me «parim fonetik» ne kuptojmë atë parim, sipas të cilit fjalët dhe pjesët e tyre të kuptim-shme shkruhen ashtu si shqiptohen. Vetë fonetikën ne e shohim në vështri-min më të gjerë si shkencën mbi tingujt e gjuhës, e cila degëzohet në fone-tikë artikullatore ose të artikullimit, që studjon fiziologjinë e formimit të tingujve të ligjërit, në fonetikë akustike, që ka të bëjë me vetitë fizike të tingujve dhe në fonetikë funksionale ose fonologji, që merret me anën linguistike, d.m.th. studjon përdorimin social të tingujve të gjuhës në procesin e marrëdhënieve midis njerëzve. Thelbi i atij që ne quajmë «parimi fonetik» në drejtshkrimin e shqipes, i cili mbështetet në një sis-tem grafik ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis shkronjës dhe tingul-lit-fonemë, është, pa dyshim, aspekti fonologjik. Por, në qoftë se pari-min fonetik do ta përkufizonim si fonologjik a fonematik, ne mendojmë se do ta ngushtonim sferën e tij, sepse në drejtshkrimin e shqipes, ka një varg ortogramesh që nuk kanë të bëjnë në vetvete me sistemin fo-nologjik, por janë pasojë e dukurive fonetike në kuptimin e ngushtë, d.m.th. kushtëzohen nga pozicioni i një tingulli të caktuar në lidhje me theksin (të tilla janë p.sh. ortogramet e sotme pa -ë fundore tek emrat e tipit *kumbull, flutur, uthull, vegël, dhelpër, tjetër, dredhëz, gjuhëz, do-rëz* etj. ose te pjesoret *dashur, pjekur, punuar* etj., ku -ë-ja fundore, që shënohej rregullisht në shekullin e kaluar, ka rënë në shqiptim e nuk shënohet as në shkrim; të tilla janë edhe ortogramet *dimri, emri, vegla,* etj.; *pastroj, pastrim* etj., si edhe ortogramet *i përbotshëm, i paanshëm, i përjetshëm, i pashmangshëm* etj., tek të cilat theksi bie mbi temën fja-lëformuese, përkundrajt *botërdar, anësor, jetësor* a *jetëdhënës, jetëgjatë, pashmangësi* etj. ku theksi kalon mbi prapashtesën a mbi rrokjen e parë të komponentit të dytë të fjalës së përbërë dhe tema mbetet në pozi-cion paratheksor etj.).

— Nga ana tjetër, parimi morfologjik kërkon që fjalët dhe pjesët e ty-

re përbërëse të sistemit trajtëformues e fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore që shkaktohen nga ligjet e gjalla fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë. Kështu, parimi morfologjik nuk përfshin këmbimet (alternimet) historike si apofonia (ablauti), metafofia (umlauti) etj. (si p.sh. *sjell-solla, heq-hoqa, marr-mora* etj., ose *plak-pleq, flas-flet, breg-brigje, heq-hiqni* etj.); trajtat e fjalëve me këto këmbime i nënshtrohen tashmë në drejtshkrim parimit fonetik. Me një fjalë, baza e parimit morfologjik të drejtshkrimit janë analogjitë morfologjike, të cilat kërkojnë që shkruesi të jetë i vetëdijshëm për morfemat e kategoritë morfologjike e kështu t'i shkruajë ato njësoj. Nga kjo pikëpamje, pa dyshim, parimi fonetik është më i thjeshtë nga ai morfologjiku, sepse nuk e kërkon një vetëdije të tillë. Megjithatë, kur flasim për këto dy parime duhet të kemi parasysh se në vetë sistemin e drejtshkrimit tonë ata nuk i kundërvihen gjithnjë njëri-tjetrit, por shpeshherë edhe përputhen a bashkëveprojnë. Të gjitha rastet e mësipërme të grupit I që i nënshtrohen plotësisht parimit fonetik, nuk vijnë në kundërshtim me parimin morfologjik, por përputhen edhe me kërkesat e tij. Kur shkruajmë, p.sh. *gur, lis, mal, rini, liri, kala* etj. ose *shkoj, punoj, çel, mbjell, lule, flas* etj. mbështetemi drejtpërdrejt tek shqiptimi, d.m.th. nuk kemi nevojë t'i drejtohem parimit morfologjik, por me këtë mënyrë shkrimi kemi dhënë njëkohësisht edhe tipet morfologjike të këtyre fjalëve, me të cilat lidhen paradigmat emërore a foljore; tek ortogramet e trajtave të shkurtëra të përemrave si *(t'i, t'u)* zbatohen njëkohësisht edhe parimi fonetik, edhe ai morfologjiku, sepse me anë të apostrofit ruhet dallimi i njërive të veçanta morfologjike e, krahas kësaj, shënohet edhe pasoja fonetike e takimeve *të + i, të + u* etj.

Megjithkëtë, në mjaft raste parimi morfologjik edhe i kundërvihet fonetikut, ose, më mirë të themi, i pret rrugën veprimit të këtij ose të atij ligji fonetik, që çon në errësimin, në shturrjen a në shkatërrimin e strukturës morfologjike-fjalëformuese e sidomos të paradigmes së fjalës. Ky kundërveprim i parimit morfologjik në sistemin drejtshkrimor ka ndikuar e ndikon në mënyrë të pandërprerë edhe mbi shqiptimin, si të themi, e «morfologjizon» atë, duke e kthyer anasjelltas kërkesën e parimit fonetik: jo vetëm «të shkruajmë ashtu si shqiptojmë», por edhe «të shqiptojmë ashtu si shkruajmë». Megjithkëtë, shkrimi dhe shqiptimi kurrë nuk përputhen në mënyrë absolute. Sado fonetik që të jetë drejtshkrimi, ai kurdoherë *përgjithëson* — sepse *grafema* nuk shënon veçoritë e nuancat pozicionale të këtij ose të atij varianti të një foneme, të alofoneve të saj, por paraqet njësitë e sistemit fonologjik të *shqipes letrare, fonemat*, si invariante dhe si gjedhe (etalone) të një radhe a të një klase të tërë variantesh, tingujsh konkretë.

Bashkëveprimi e kundërveprimi i parimit morfologjik me atë fonetik duken sidomos në fjalët e grupit II. Le të marrim një problem-nyje, që i del drejtshkrimit të sotëm për shkak të dallimeve fonetike midis dy dialekteve të shqipes e të evolucionit të strukturës fonetike të shqipes — shkrimin e *ë-së* së patheksuar në pozicione të saj të ndryshme.

Problemi i *ë-së* së patheksuar është ndofta më i koklavituri për drejtshkrimin e shqipes. Atë e kanë koklavitur edhe më tepër përpjekjet për ta zgjidhur nga baza *thjesht fonetike e dialektore*. Është e kup-

tueshme përse për këtë çështje janë bërë e vazhdojnë të bëhen diskutimet më të shumta e më të zjarra. Lind pyetja: si mund të zgjidhet në kohën tonë ky problem, që nuk ka gjetur një trajtim plotësisht konsekuent as në Projektin e 1967-ës?

Atë nuk mund ta zgjidhim duke u mbështetur vetëm në parimin fonetik, d.m.th. vetëm tek shqiptimi e aqë më tepër te ky ose ai shqiptim dialektor e nëndialektor, siç është vepruar shpeshherë në të kaluarën ose edhe gjatë diskutimit rreth «Rregullave të drejtshkrimit» të 1967-ës. Atë nuk mund ta zgjidhim as duke e mbështetur vetëm tek parimi morfologjik. Gjuha jonë letrare, ashtu si edhe çdo gjuhë tjetër, nuk është një sistem me vija të drejta, por përbën një tërësi komplekse të formuar historikisht e gjithnjë në zhvillim, një sistem sistemesh, që bashkëjetojnë dhe evoluojnë në marrëdhënie dialektike. Gjuha jonë letrare, sado e kristalizuar që të jetë, nuk ka edhe as ka për të pasur vetëm rregullsi, analogji, por ka e do të ketë edhe «pararegullsi», anomali të cilat janë rrjedhim i veprimit historik të ligjeve të caktuara gjuhësore e të faktorëve shoqërorë. Në një aspekt të veçantë, vijat e drejta janë, në thelb, edhe vija dialektore, sepse përjashtojnë pasojat e bashkëveprimit ndër-dialektor në shqipen letrare. Prandaj, po të duam të qëndrojmë në një truall me të vërtetë objektiv, jo krahinor, por kombëtar në trajtimin e problemeve të drejtshkrimit të gjuhës sonë letrare, duhet ta kërkojmë zgjidhjen e tyre në tërë sistemin drejtshkrimor e, para së gjithash në bashkëveprimin e parimit fonetik me atë morfologjik. Edhe atëhere kur i drejtohem parimit fonetik, nuk mund ta vemë në një plan drejtshkrimin e drejtshqiptimin: së pari sepse kristalizimi i normës letrare të përbashkët bëhet, në radhë të parë, në trajtën e saj të shkruar dhe drejtshkrimi lidhet pikërisht me këtë trajtë; së dyti, sepse drejtshkrimi është një shkallë më e lartë përgjithësimi se sa shqiptimi dhe mbështetet jo tek të gjitha stilet e shqiptimit, por kryesisht tek stili libror i tij, i cili lidhet drejtpërdrejt me gjuhën e shkruar dhe është stili më i plotë, më i shkoqitur, më i qartë. Drejtshkrimi mund të ruajë edhe atë që shqiptimi mezi e «shënon» ose nuk e ruan fare dhe të ndikojë që ruajtja në shkrim të kthehet edhe në ruajtje në shqiptim. Kjo është një dukuri e gjallë në gjuhën tonë letrare, sepse thelbi i marrëdhënieve midis drejtshkrimit e drejtshqiptimit të shqipes mbetet gjithnjë tendenca e sistemit tonë grafik për barazimin midis shkronjës e tingullit, d.m.th. prirja që të mos ketë shkronja të ashtuquajtura parazitare.

Po ta shohim në këtë dritë problemin e (ë-së) së patheksuar mund të arrijmë në një përcaktim më të drejtë e parimor të ortogrameve që lidhen me të. Si pikënisje do të marrim, pa tjetër, vetë tiparet dalluese fonologjike të këtij tingulli. Sipas studimeve të fonetistëve tanë, «ë-ja e patheksuar është një tingull i shkurtër, i reduktuar, i radhës së përzier, i palabializuar, i ngritjes së mesme, por më i hapur se ë-ja e theksuar»; ajo «bën pjesë në grupin e atyre zanoreve që quhen të lëvizshme, të paqëndrueshme» dhe «në shqiptimin libror e në të folur të ngadalshëm ruhet më mirë se në stilin e bisedimit e në të folur të shpejtë»⁴³. Ka rëndësi të mbajmë parasysh se në gjuhën e sotme shqipe reduktimit i

43) Shih A. Dodi, vep. cit.

nënshtrohet jo vetëm ë-ja e patheksuar, por të gjitha zanoret e patheksuara; tek ë-ja është më e madhe *vetëm shkalla e reduktimit*, e cila në raste të caktuara arrin deri në rënien e saj të plotë. Në *përgjithësi* drejtshkrimi i sotëm, që mbështetet te shqiptimi letrar i stilit të plotë, nuk i pasqyron reduktimet e zanoreve të patheksuara, kur ato nuk prekin tiparet dalluese të fonemës; ai udhëhiqet nga njëri prej ligjeve themelore të vokalizmit të sotëm letrar — nga prirja e ruajtjes së cilësisë së zanoreve të patheksuara. Nga kjo prirje nuk përjashtohet as reduktimi jocular i ë-së së patheksuar. Kështu, *pasqyrimi në drejtshkrimin e sotëm i ë-së së patheksuar në rrokje nistore* (ortogrami *dëgjoj, gjëmon, këpucë, këndoj, mëngjez shëndet*), në rrokje të hapur jofundore (ortogrami *gjallëri, madhëri, mbarësi, gjakësi, hjekësi, lajmësi, mbretëri, botëror, tokësor, si edhe vegjëli, varfëri, dhëlpëri, dhëndëri, poshtëroj, shtrembëroj*), në rrokje fundore të mbyllur pastheksore (ortogrami *i ashpër, i vogël, ashkël, vegël, pupël, gogël, kokërr, dhëlpër, pjepër, gjarpër, nxënës, ndihmës, lypës*), si edhe në fjalët proklitike (*më, në, të* etj. — krhs. *më dha një lajm, lundron në det, lajmëroje të niset, s'të njoh* etj.) është në pajtim të plotë me prirjen mbizotëruese në sistemin e sotëm *fonetik të gjuhës sonë letrare dhe me normën shqiptimore librore*. Prandaj këto ortograme mund të quhen shkencërisht të drejta. Më e ndërlikuar paraqitet çështja e *ë-së së patheksuar në rrokje të hapët fundore*, ku reduktimi ka arritur shkallën e tij më të tejme. Sipas vëzhgimeve të reja, në ligjërimin *bisedor* «ë-ja në këtë pozicion ka përfunduar në një *tingullth të shkurtër, që përfaqëson një zanore të shurdhët*, e cila u jep një ngjyrim karakteristik më -ë bashkëtingëlloreve fundore»; ndërsa «në fundoren absolute e përpara bashkëtingëlloreve të shurdhëta të fjalës ndjekëse ky tingullth i shurdhët dëgjohet më qartë», përpara *bashkëtingëlloreve të zëshme* «reduktohet edhe më tepër» dhe «përpara një zanoreje tjetër të fjalës ndjekëse» (duke përfshirë këtu edhe hyrjen e temave me ë fundore të patheksuar si komponentë të parë në fjalë të përbëra e të përngjitura) «mungon krejt». Në stilin e *plotë* të shqiptimit tingullthi fundor -ë ndihet më i qartë se në atë bisedor. Pa dyshim, në këtë rast. për të vendosur ortograme të drejta, nuk mjafton vetëm parimi fonetik, Pikërisht këtu ndërhyjnë parimi morfologjik e bashkë me të edhe parimi semantik, në bazë të të cilëve vlerësohen rrjedhimet gramatikore e leksiko-semantike të ruajtjes apo të heqjes së ë-së në drejtshkrim. Nga pikëpamja fonetike ë-ja, vërtet, nuk është zhdukur fare, përfaqësohet akoma nga një «tingullth», por është lëkundur mjaft, është bërë e paqëndrueshme dhe në vetëdijen gjuhësore të folësve të sotëm të shqipes, sidomos tek disa breza, në mjaft raste shtron pyetjen — ka apo s'ka këtu një -ë? Kjo lejon që për drejtshkrimin në raste të tilla të ketë dy zgjidhje — këto fjalë mund të shkruhen me -ë, por mund të shkruhen edhe pa -ë: në të dyja rastet mospërputhja e drejtshkrimit me realitetin fonetik nuk do të ishte e madhe. Por puna nuk qëndron kështu po të vështrohen këto dy mundësi zgjidhjeje në aspektin gramatikor e leksikor — ruajtja ose jo e ë-së fundore në shqipen e shkruar në këto aspekte do të kishte pasoja shumë të rëndësishme. Kjo -ë fundore në shqipen kryen disa funksione në fushën e morfologjisë. Ajo karakterizon *temat emërore* më -ë (*botë, ditë, hekurudhë* etj.), duke përcaktuar kështu një ndarje dihotomike të për-

gjithshme të tipave të lakimit (krhs. emrat e lakimit të tretë të tipit *mollë-a* dhe ata të lakimit të parë e të dytë: *lis-i* dhe *fik-u*); kështu *-ë-ja* fundore vepron edhe si sinjal gramatikor-tregues i gjinisë. Ajo është një nga elementet diferencuese më të rëndësishme në paradigmat emërore (në kundërvënjen e trajtave të shumësit me ato të njëjësit (krhs. *gur-gurë*, *mjek-mjeko*, *çlirimtar-çlirimtarë*), dhe në paradigmat foljore (në shumësin e së tashmes së dëftores — *punojmë*, *punojnë*, në lidhoren — *të punojë*, *të vejë*, në të ardhmen e dëftores — *do të punojë*, *do të punojmë*, në dëshiroren — *punoftë*, *rroftë*, në pjesoren — *dalë*, *parë*, *mbjellë*, *dhënë*). Ajo është tregues formal i klasave të caktuara të mbiemrave të nyjshëm më *-ë* ose më *-të* (*i mirë*, *i përciptë*), që në shqipen e sotme janë disa mijëra, etj. Krahas kësaj, ajo kryen funksione të rëndësishme edhe në fushën e fjalëformimit e të leksikut: shërben si formant mocioni për një kategori emrash (krhs. *zog-zogë*, *plak-plakë*), si prapashtesë e veçantë produktive e emrave të veprimit e të rezultatit të veprimit (shih p.sh. *blojë*, *lojë*, *mbulojë*, *mburojë*, *pasojë*, *pres*, *pritë*, *shtrojë*, *rrenojë* etj.) dhe si element fundor i shumë prapashtesave si *-ajkë*, *-allë*, *-amë*, *-anë*, *-ashkë*, *-atë*, *-avë*, *-çinë*, *-çkë*, *-dhë*, *-ellë*, *-emë*, *-enjë*, *-esë*, *-eshë*, *-etë*, *-një*, *-(ë)sirë/-(ë)sirë*, *-içkë*, *-imë*, *-inë*, *-injë*, *-iskë*, *-ishtë*, *-itë*, *-linë*, *-më*, *-najë*, *-onjë/-ojë*, *omë*, *-otë*, *-ovinë*, *-së*, *-shë*, *-shtë*, *-të*, *-tinë/tirë*, *-tyrë*, *-ucë/-uckë*, *-një/-ujkë*, *-ullë*, *-ushë/-ushkë*, *-zë* etj.⁴⁴, kryen edhe funksionin e zanores lidhëse-neutralizuese në fjalët e përbëra (krhs. *gu-shëkuq*, *ballëlant*, *kokëfortë*) etj. Ajo shërben si fonemë që nuk lejon shndërrimin në homonime e homoforma të rreth 500 fjalëve të leksikut më të përdorshëm të shqipes (krhs. p.sh. *an-i* e.m. dhe *anë-a* e.f., *ar-i* dhe *arë-a*, *bark-u* dhe *barkë-a*, *bir-i* dhe *birë-a*, *breth-i* dhe *brethë-a*, *bung-u* dhe *bungë-a*, *ferr-i* dhe *ferrë-a*, *hallk-u* dhe *hallkë-a*, *kob-i* dhe *kobë-a*, *krom-i* dhe *kromë-a*, *lek-u* dhe *lekë-a* *lug-u* dhe *lugë-a*, *maj-i* dhe *majë-a*, *myk-u* dhe *mykë-a*, *sup-i* dhe *supë-a*, *shpat-i* dhe *shpatë-a*, *ves-i* dhe *vesë-a*, *vidh-i*, dhe *vidhë-a*, etj.; krhs. gjithashtu *peshoj* folje dhe *peshojë-a* e.f., *pres* dhe *presë*, *rras* dhe *rrasë-a*, *rrjedh* dhe *rrjedhë*, *sit* dhe *sitë*, *shij* dhe *shijë-a*, *zgjedh* dhe *zgjedhë-a*, etj. *boll* ndf. dhe *bollë-a* etj.). *Kuptohet vetvetiu se heqja e -ë-së* fundore në shkrimin e klasëve të fjalëve të lartpërmendura do të kishte pasoja të rënda, sepse do të sillte ndryshime thelbësore në strukturën gramatikore e fjalëformuese të shqipes letrare, duke përzier tipat e lakimeve e duke shturrur paradigmat emërore e foljore; përveç kësaj, ajo do të ndryshonte përbërjen e shumë prapashtesave e të temave fjalëformuese. Në leksik ajo do të krijonte çifte e bile edhe treshe homonimesh, ndërsa, siç dihet, në gjuhën tonë vepron e gjallë prirja për dehomonimizim si në fushën e fjalëve, ashtu edhe në atë të trajtave. Heqja e *-ë-së* fundore në drejtshkrim, që do të pasqyrohej edhe në drejtshqiptim, do të sillte ndryshime të mëdha edhe në tipat rrokjesorë (silabike) të leksikut të shqipes. Po e sqarojmë këtë në dritën e pasqyrës së mëposhtme, ku zberthehet struktura rrokjesore e 24.048 fjalëve më të përdorshme.

44) Shih më hollësisht për këto: A. Xhuvani dhe E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.

Tipat rrokjesorë të fjalëve të shqipes së sotme

Numri i rrokjeve të fjalëve në trajtën përfaqësuese	Numri i fjalëve në tërësinë e leksikut	Përqindja mbi gjithë leksikun
1. Fjalë njërrrokëshe	2.485	10,33%
2. » dyrrrokëshe	10.263	42,67%
3. » trirrokëshe	7.636	31,75%
4. » katërrrokëshe	2.975	12,37%
5. » pesërrrokëshe	532	2,21%
6. » gjashtërrrokëshe	130	0,54%
7. » shtatërrrokëshe	19	0,07%
8. » tetërrrokëshe. . . .	8	0,03%

Siç shihet, sot në shqipen e folur e të shkruar, në trajtat përfaqësuese rreth gjysmën e përbëjnë fjalët *dyrrrokëshe*. Ky grup plotësohet edhe nga shndërrimi i fjalëve njërrrokëshe në dyrrrokëshe në shumicën e trajtave paradigmore (krh. *bar-bari, barit; det-deti, detit; flas-fola, foltë; shkoj-shkova, shkoja-shkuar*, etj.). Me një fjalë, boshti i leksikut të shqipes së sotme dhe tendenca e tij është, në radhë të parë, struktura dyrrrokëshe e fjalës dhe jo ajo njërrrokëshe ose monosilabizmi. Rënia e *-ë-së* fundore, që takohet kryesisht tek fjalë dyrrrokëshe të tipit *arë, dorë, bukë, ujë, tokë, valë* etj., do t'i kalonte këto në tipin njërrrokësh, në kundërshtim me tendencën themelore të ndërtimit rrokjesor të leksikut të shqipes.

Në tërësinë e pasojave negative të mospasqyrimit të *-ë-së* fundore të patheksuar në drejtshkrim vendin e parë e zënë pasojat morfologjike dhe, ndër to, ato të sistemit emëror. Këtu shtrohet një çështje e qenësishme për vetë këtë sistem — a duhet ta ruajë e ta përforcojë drejtshkrimi ndarjen e madhe midis emrave mashkullorë e femërorë që shprehet në dy tipat e temave — me bashkëtingëllore dhe më *-ë* (ndarje që në një glosar prej rreth 25.000 fjalësh përfshin dy grupe të gjera: rreth 6000 emra mashkullorë dhe rreth 4000 femërorë), apo duhet të përkrahë shturrjen e kësaj dihotomie, e cila është thyer me kalimin e më se 500 emrave femërorë trirrokësh më *-ë* (tipi *kumbull, gjuhëz*) në dyrrrokësh më bashkëtingëllore? Mendojmë se kësaj pyetjeje kërkesat e normës letrare të sotme mund t'i përgjigjen vetëm në mënyrë pohuese — po, drejtshkrimi duhet të synojë ta ruajë dihotominë themelore të mësipërme. Një veprim i kundërt, në këtë rast, përveç të tjerash, do të kërkonte edhe ringjalljen e sasisë (kuantitetit) të zanoreve në drejtshkrim, dukuri që është përjashtuar që nga Komisia Letrare e Shkodrës dhe që nga pikëpamja funksionale sot ka karakter të ngushtë dialektor.

Të gjitha pasojat negative që do të sillte rënja e *-ë-së* në strukturën gramatikore, fjalëformuese e leksikore bëjnë që parimi morfologjik, në radhë të parë, e bashkë me të edhe ai semantik të përkrahin prirjen që e ruan *-ë-në* në strukturën fonetike të shqipes së sotme, d.m.th. në shqiptimin letrar e të pengojnë prirjen e kundërt. Siç shihet, zgjidhjen ky problem e gjen në bashkëveprimin e tre parimeve, por, me sa duket, vendimtare në këtë bashkëveprim është trysnia e morfologjisë. Megjithatë, zbatimi i parimeve të tjera mund ta përkrahë ruajtjen e *-ë-së* së patheksuar fundore, atje ku ajo, qoftë edhe në një masë fare të vogël, ndihet në shqiptim, të paktën tek brezat e rinj, por nuk mund ta përkrahë atje ku ajo, për arsye të forta fonetike, është zhdukur fare *pa asnjë*

gjurmë (kështu p.sh. tek raste si *tjegull-tjegulla, flutur-flutura, gishtëz-gishtëza ë-ja* fundore, dy rrokje larg theksit ka rënë përfundimisht dhe nuk mund të ringjallet në drejtshkrim; e njëjta gjë mund të thuhet edhe për *ë-në* jofundore pastheksore që bie tek emrat e mbiemrat të tipit *vegël-vegla, letër-letra, i vjetër-e vjetra, i egër-i egri* etj., si edhe për *-ë-në* fundore të temave që hyjnë si komponentë të parë në fjalët e përbëra të tipit *bashkatdhetar, bashkudhëtar, i gjithanshëm* etj., sepse në këto raste rënia e *ë-së* nuk sjell ndonjë pasojë të karakterit thjesht morfologjik.

Po ta kundronim, pas këtyre arësytetimeve, zanoren *ë* në tërësinë e vargut fonemor mund të arrinim të caktonim një vijë ndarëse si cak për pasqyrimin ose jo të saj në drejtshkrimin e sotëm:

[ë ₁]	[ë ₂]	[ë ₃]	[ë ₄]
(gjë)	(rëndo)	(vërtet)	(dimër)
(rrëzë)	(rrëmbej)	(vërtit)	(zemër)
(dërmë)	(rënkuj)	(kërkoj)	(letër)
(velënxë)	(rrëmujë)	(përsos)	(dhëlpër)
(i ëmbël)	(këndoj)	(përlaj)	(kulloshtër)
(gërthje)	(lëndoj)	(përse)	(kulshedër)
	(lëroj)	(përshesh)	(zhytër)
		(mbërthej)	(i pastër)
		(kërbishtë)	(i vogël)
		(zgërdhëm)	
		(gërshet)	
		(bërtas)	
		(tërmet)	
		(stërnip)	
		(stërholloj)	
[ë ₅]	[ë ₆]	[ë ₇]	[ë ₈]
(blerës)	(armëtar)	(i zellshëm)	(ëmbëlsi)
(shitës)	(harkëtar)	(i hershëm)	(madhështi)
(folës)	(arkëtar)	(i ngadalshëm)	(hapësirë)
(nxënës)	(lajmëtar)	(i rrjedhshëm)	
(korrës)	(ndihmëtar)	(i jashtëm)	
(nxitës)	(zbardhëllen)		
(mbartës)			
(anës)			
(ditës)			
(ndihmës)			
[ë ₉]	[ë ₁₀]	[ë ₁₁]	[ë ₁₂]
(hartë)	(pëmëshitës)	(pleqëri)	(botë)
(shparcë)	(armëmbajtës)	(mbarësi)	(ietë)
(palcë)	(dorëcung)	(madhëri)	(tokë)
(i thartë)	(degëshumë)	(dhëlpëri)	(udhë)
(i thantë)	(fletëgjërë)		(lugë)
			(mashë)
[ë ₁₃]		[ë _n]	[ë zero]
(pënëtor)			
(anëtar)			

Të gjitha gjymtyrët që përfshihen në këtë varg fonemor që nga etaloni \bar{e}_1 (ë-ja e theksuar që ka tiparet dalluese maksimale) deri tek \bar{e}_n në një shkallë zbritëse kanë tiparin dallues fonologjik që i lidh me fonemën \bar{e} (si lidhje midis varianteve dhe invariantit), pra zotërojnë në shkallë të ndryshme një funksion të përbashkët kuptim-dallues. Si të tilla, pavarësisht nga dobësimi i këtij tiparit në këtë ose atë variant, ato në një masë me vlerë funksionale shqiptohen dhe parimisht edhe nga aspekti fonologjik mund të pasqyrohen në drejtshkrim. Pas \bar{e}_n kalon kufiri kur lidhja midis variantit dhe invariantit shuhet, variant nuk ka më dhe kjo na jep të drejtë, si rregull, të mos e pasqyrojmë \bar{e} -në në drejtshkrim. Detyra e caktimit të këtij kufiri i takon fonetikës dhe jo morfologjisë, por kjo e fundit, për hir të njësimin e të thjeshtimit të trajtave, mund të kërkojë, në raste të veçuara, shkrimin e \bar{e} -së edhe përtej kufirit të mësipërm (kështu mund të veprohej p.sh. në rastin e shumësit të pashquar të emrave të masave: mund të shkruhej pesë milionë, njëzet lekë në pajtim me tipin *gur-ë*, dhe me trajtën e shquar: *milionët, lekët*).

Mund të themi, pra, se çështja e \bar{e} -së së patheksuar në drejtshkrimin e sotëm, në shumicën e rasteve zgjidhet në bazë të parimit fonetik, kurse në rastin e \bar{e} -së fundore e në ndonjë rast tjetër luan rol vendimtar edhe parimi morfologjik, por jo gjithnjë ai i kundërvihet fonetikut.

Një analizë e tillë dialektike jep bazën shkencore edhe për zgjidhjen e problemeve të tjera të rëndësishme, siç është p.sh. ai i ortogrameve të fjalëve me bashkëtingëllore të zëshme (në fund e në trup të tyre) që në dialektin jugor kryesisht shurdhohet, i shkrimit të fjalëve ku takohet një temë me $-g$ ose n - me prapashtesën $-je$, i shkrimit të varianteve fonetike të parashtesës $-ç/-sh/-zh$ etj.

— S'ka dyshim se parimi fonetik, si në të kaluarën, ashtu edhe sot mbetet parimi kryesor i drejtshkrimit të shqipes. Kjo lidhet me veçoritë thelbësore të sistemit grafik të shqipes dhe të strukturës së saj fonetike. Ndryshe nga ç'ndodh në gjuhë të tjera si anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, rusishtja, etj., në sistemin grafik të shqipes zotëron pothuajse plotësisht paraqitja e një foneme nga një shkronjë-grafemë e vetme dhe kjo në shumicën e hallkave të sistemit drejtshkrimor e bën të paqenë nevojën që për ruajtjen e njësisë së figurës grafike, vizuale të fjalës e të morfemave, të veprojë gjerësisht parimi morfologjik. Rastet kur një shkronjë shënon disa fonema ose kur disa shkronja shënojnë një fonemë në drejtshkrimin e shqipes janë të pakta. Të tilla janë, p.sh. ortogramet e tipit *italian, material* etj., ku shkronja *i* përveç vlerës së saj themelore në sistemin grafik, *[i]*, kryen edhe funksione plotësuese, duke shënuar edhe fonemën *[j]*, e cila gjen, kështu, dy shprehje grafike $-i$ dhe $j-$, në bazë të mbizotërimit të parimit etimologjik-tradicional mbi atë fonetik ose ortogramet *s'bën, s'del, s'di, s'deshi, s'gënjen, s'vete* etj., ku, në kundërshtim me shqiptimin *[zbën], [zdel]* etj., ruajtja e njësisë së morfemës *s'* kryhet nga zbatimi i parimit morfologjik, kështu që shkronja *s* kryen edhe funksione plotësuese dhe bëhet shprehëse e dy fonemave të çiftit opozicional *[s]* e *[z]*.

Sa më shumë thellohem në të kaluarën aq më fonetik bëhet drejt-

shkrimi i shqipes dhe sa më shumë i afrohem kohës sonë — aq më shumë fonologjizohet. Krahas kësaj vije zhvillimi, sidomos që nga Rilindja e këtej, në drejtshkrimin e shqipes, fillon të rritet pesha e parimit morfologjik, kështu që vija themelore e fonologjizimit të tij shoqërohet edhe nga ajo e morfologjizimit. Vetë kërkesat e parimit morfologjik fillojnë të veprojnë aty ku zbatimi i parimit fonetik e prish njësinë e trajtave ose e errëson dhe e gërryen strukturën fjalë-formuese.

Kur flasim për zbatimin e parimit fonetik, me të drejtë dalin dy pyetje — tek i cili shqiptim do të mbështetemi dhe si do të mbështetemi tek shqiptimi, kur dihet se drejtshqiptimi në të gjitha gjuhët letrare mbetet prapa drejtshkrimit?

Për pyetjen e parë përgjigja është më e thjeshtë — do të mbështetemi, pa dyshim tek shqiptimi më i përgjithshëm, *letrar*, në stilin e tij të plotë dhe jo tek shqiptimet e veçanta dialektore. Çështja e dytë paraqitet më e ndërlikuar. Është e vërtetë që norma drejtshqiptimore kristalizohet më vonë se ajo drejtshkrimorja. Kjo vihet re edhe në shqipen e sotme letrare. Por kjo nuk do të thotë aspak se drejtshqiptimi mbetet prapa në të gjitha hallkat e tij. Po të ndodhte një gjë e tillë, sot do të kishim një hendek të thellë, të pakapërcyeshëm midis shqiptimit e shkrimit dhe ky i fundit do të ishte shkëputur me kohë nga struktura fonetike e gjuhës letrare.

Përkundrazi, në një varg hallkash themelore shqiptimi *letrar i prin* shkrimit dhe i jep këtij një bazë ku të mbështetet për ortogramet. Po të krahasojmë zgjidhjet e drejtshkrimit tonë që bazohen tek shqiptimi letrar, do të shohim se në ato hallka norma drejtshqiptimore ose është vendosur ose ka shfaqur një prirje të qartë zhvillimi. Ne kemi sot një drejtshqiptim letrar, që përfshin shtresa të gjera të arësimeve të popullsisë, sidomos të asaj së qyteteve e që gjen shprehje konkrete sidomos në shqiptimin e folësve më të mirë të Radio-Tiranës, në shqiptimin që tingëllon në konferencat e kongreset kombëtare dhe në mbledhjet me karakter të gjerë shoqëror, në klasat e shkollave e në auditoret universitare. Drejtshqiptimi mbështetet tek një bazë e përbashkët e artikullimit, që tashmë është formuar si bazë kombëtare përmbi këtë ose atë bazë të ngushtë të artikullimit dialektor. Kristalizimin e normës së sotme shqiptimore drejtshkrimi e sheh në planin cilësor dhe jo sasior. Siç dihet, ky shqiptim shkallë-shkallë po çel rrugë në gjithë veprimtarinë tonë gjuhësore shoqërore, por, sigurisht, përhapja e ngulitja e tij shtrihen më ngadalë në masat e gjera, sidomos në fshat, sepse shqiptimi ka të bëjë drejtpërdrejt me truallin gjuhësor më të vështirë — me dialektet, që vazhdojnë të jetojnë e do të jetojnë pikërisht *vetëm* në trajtën e folur. Kështu, ndërsa ortogramet ne i përcaktojmë njëkohësisht edhe në bazë të normës shqiptimore tashmë të kristalizuara, edhe në bazë të prirjeve pak a shumë të qarta të kësaj norme drejt kristalizimit, sidomos tek brezat më aktivë të popullsisë dhe këto ortograme zbatohen menjëherë në gjithë gjuhën e shkruar, në shqiptim një gjë e tillë nuk ndodh: — prirjet këtu vazhdojnë të mbeten prirje edhe për një kohë pak a shumë të gjatë dhe në përgjithësi norma drejtshqiptimore nuk përfshin menjëherë të gjithë truallin e gjuhës së folur, të gjitha stilet e saj. Kështu ne e kuptojmë prapambetjen e normës drejtshqiptimore dhe pikë-

risht për këtë arsye në drejtshkrimin e sotëm, *aty ku norma drejtshqiptimore* nga pikëpamja *cilësore* nuk ka shfaqur prirje të qarta zhvillimi, ortogramet përcaktohen jo në bazë të parimit fonetik, por të parimeve të tjera. Këtë e kërkon vetë qëndrueshmëria e drejtshkrimit.

Parimet e tjera, si parimi etimologjik a historik-tradicional, parimi semantik e simbolik në drejtshkrimin e shqipes zënë një vend më të vogël, por jo të papërfillshëm. Sidomos parimi semantik që shërben për shkrimin e fjalëve bashkë, ndaras a me vizë në mes dhe ai simbolik, ku mbështetet përdorimi i shkronjave të mëdha, i datave historike etj. kanë një zbatim mjaft të gjerë.

Drejtshkrimi duhet të bashkojë nivelin sa më të lartë shkencor të zgjidhjeve me thjeshtësinë e rregullave dhe të sigurojë një qëndrueshmëri sa më të madhe. Në mendojmë se kërkesa për ta thjeshtuar Projektin e 1967-ës është me vend. Thjeshtimi mund të bëhet në disa drejtime. Së pari, mund të bëhen grupime më të gjera të rregullave me njësimë më të mëdha. Së dyti, mund të thjeshtohet vetë formulimi i rregullave; sidomos kanë nevojë të zgjidhen më thjesht e më qartë çështjet e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit dhe përdorimi i shkronjave të mëdha. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që për çdo rregull të jepet pa tjetër një argumentim a motivim shkencor. Vetë drejtshkrimi, si një kod përgjithësues që duhet të mësohet, vetë zbatimi i parimeve të ndryshme në të dhe karakteri jo i njëlojtë i materialit që trajtohet, kanë si rrjedhim logjik që në një kod drejtshkrimor të gërshetohen tri lloje rregullash: a) rregulla udhëheqse, ku jepen kushtet, në të cilat duhet të zgjidhet pikërisht një ortogram i caktuar dhe jo një tjetër; b) rregulla dëftuese, ku nuk jepet ndonjë kusht a motivim, por konstatohet se në këtë ose atë rast duhet shkruar kështu, pra vetëm dëftohet si duhet shkruar; e tillë është p.sh., rregulla që jepet në Projekt për shkrimin e fjalëve me *r* të fortë (*rr*), sepse këto ortograme nuk mund të arësyetohen vetëm me kundërvënjen e çifteve fonologjike të caktuara: me *rr* shkruhen edhe fjalë që nuk hyjnë në çifte të tilla; c) rregulla udhëzuese, që sqarojnë se si duhet vepruar për të gjetur zgjidhjen e sakte drejtshkrimore. Së treti, ka mundësi të pakësohet numri i rregullave e i përjashtimeve. Projekti i sotëm ka 255 rregulla e 57 përjashtime e sqarime. Ky nuk është një numër i madh, po të kemi parasysh që disa nga gjuhët më të mëdha të Evropës kanë drejtshkrime me 400 e 500 rregulla. Por ne mund ta pakësojmë edhe më tej numrin e rregullave e të përjashtimeve. Së katërti, zbatimi i Projektit gjatë këtyre 5-6 vjetëve tregoi se ka mundësi që në përpunimin e fundit të pakësohen më tej edhe zgjidhjet dyfishe. Të gjitha këto do të bëjnë që drejtshkrimi i shqipes letrare të përvetësohet më lehtë nga masat e gjera dhe do t'i japin atij një karakter më të qëndrueshëm.

Sot gjuha shqipe studjohet gjerësisht edhe nga të huajt, jo vetëm për qëllime shkencore, por edhe për nevoja praktike. Gjatë diskutimit të Projektit u vu në dukje që në hartimin përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit të kihet parasysh edhe ky aspekt. Kjo është një kërkesë e drejtë. Po për të qenë i mirë për të huajt, drejtshkrimi i shqipes duhet, në radhë të parë, të jetë i mirë për shqiptarët.

Zgjidhja sa më e plotë e të gjitha këtyre kërkesave pa dyshim, ka rëndësi të madhe praktike. Por në fund të fundit zgjidhjet praktike për-

caktohen nga zgjidhja teorike — sa më shkencore e objektive të jetë kjo, aq më të qarta e të qëndrueshme do të jenë edhe zgjidhjet praktike. Prandaj koncepti i ri teorik, që e dallon Projektin e 1967-ës nga të gjitha drejtshkrimet e mëparshme, mund të thellohet edhe më tej e të përshkojë të gjitha rregullat në mënyrë më konsekuente. Është pikërisht baza e shëndoshë teorike që i jep edhe qëndrueshmëri drejtshkrimit. Vetëm se kjo qëndrueshmëri duhet kuptuar gjithnjë si qëndrueshmëri relative, e parë në kuadrin e fazës së sotme të zhvillimit të gjuhës letrare. Qëndrueshmëri të përjetshme, absolute nuk ka as në gjuhë, pra as në drejtshkrim nuk mund të ketë rregulla përfundimtare në kuptimin absolut të fjalës. Qëndrueshmëria e drejtshkrimit arrihet me tri rrugë: — (a) duke zhdukur luhatjet në shkrim me vendosjen e një ortogrami të vetëm (b) duke e lidhur drejtshkrimin me etimologjinë dhe (c) duke ruajtur traditën në kundërshtim me ndryshimin e sistemit tingullor të gjuhës. Drejtshkrimi ynë ka ecur dhe vazhdon të ecë kryesisht në rrugën e parë, e cila, siç thotë me të drejtë Herman Pauli, zakonisht «është progres ose, sidoqoftë, jo regres»⁴⁵, sepse lejon një qëndrueshmëri relative të drejtshkrimit, pa e shkëputur asnjëherë atë nga gjuha e gjallë e popullit. Ecja në këtë rrugë do të lejojë që edhe në të ardhmen, mbi bazën e drejtshkrimit të qëndrueshëm që do të miratojë ky Kongres, të bëhen përmirësime të mëtejshme, duke u udhëhequr nga përparimi i gjuhës sonë letrare kombëtare dhe nga analiza gjithnjë më e thellë shkencore e strukturës së saj. E gjithë puna normativizuese, rregulluese që është bërë e po bëhet nga shkenca jonë gjuhësore mbështetet në njohjen e ligjeve objektive të zhvillimit të gjuhës letrare dhe synon të lehtësojë veprimin e tyre. Siç e ka thënë me të drejtë J. Vandriesi, përpjekjet për të zhdukur të metat e drejtshkrimit «nuk mund të shihen veçse me miratim», sepse «ne nuk ndërhyjmë në jetën e gjuhës duke ndrequr drejtshkrimin e saj; ne vetëm e shpëtojmë atë nga një sëmundje që e bren»⁴⁶.

Pikërisht këto përpjekje të parreshtura kanë bërë që sot drejtshkrimi i shqipes të jetë një nga më të thjeshtët e më të lehtët për t'u përvetësuar. Midis dy skajeve të drejtshkrimeve të gjuhëve evropiane — atij historik-tradicional të anglishtes, ku 44 tinguj jepen nga më se 500 simbole dhe atij të spanjishtes që shihet si një nga më të thjeshtët — drejtshkrimi ynë i afrohet pikërisht këtij të dytit. Megjithatë, përvetësimi i tij kërkon një punë të gjerë në të gjitha hallkat e formimit gjuhësor të popullit tonë. Në mënyrë të veçantë drejtshkrimi i ri duhet të vlejë për një përmirësim të mëtejshëm të mësimin të gjuhës letrare shqipe në shkollë e të përgatitjes së mësuesve të gjuhës. Mësimi i gjuhës amtare në shkollën 8-vjeçare pas çlirimit ka ardhur duke u bërë gjithnjë më i mirë, si nga përmbajtja, ashtu edhe nga metodat. Asnjëherë shkolla shqipe nuk ka pasur tekste të tilla gjuhe e letërsie si ato që ka sot. Megjithatë mësimi i gjuhës në shkollën tonë ka akoma mjaft dobësi. Kjo vihet re edhe në përqindjen e lartë të gabimeve drejtshkrimore që bëjnë nxënësit tanë. Drejtshkrimi i ri mund t'i lehtësojë përpjekjet për t'i pakësuar e për t'i zhdukur këto gabime,

45) Shih Hermann Paul, *Prinzipien der Sprachgeschichte*, Halle 1937, § 270.

46) J. Vendryes, *Le Langage*. Introduction linguistique à l'histoire, Paris, 1923, f. 305.

duke kërkuar edhe një kohë më të paktë për t'u mësuar. Kjo e bën të nevojshme që përvetësimi i tij të lidhet më mirë se sa deri më sot me strukturën fonetiko-gramatikore e fjalëformuese të shqipes, që puna për shqiptimin e drejtë të zërë një vend më të madh në detyrat e mësuesve të gjuhës e të letërsisë shqipe dhe që gjithë mësimi i gjuhës amtare të mbështetet në harmonizimin e plotë të tre aspekteve gjuhësore që bashkëjetojnë brenda mureve të shkollës — të gjuhës së tekstit, të gjuhës së mësuesit e të gjuhës së nxënësit, duke u udhëhequr kurdoherë nga gjuha e tekstit. Kjo do të arrihet në luftë edhe me mbeturinat e metodave antigramatiste të së kaluarës në përvetësimin e drejtshkrimit që vihen re akoma aty-këtu në shkollën tonë dhe që pasqyrojnë ndikimin e disa pikëpamjeve, të cilat rolin kryesor në këtë proces ja japin «ligjit të ushtrimeve», të kuptuar thjesht mekanikisht si ligji i përforcimit të lidhjes midis «stimulit» dhe «reaksionit» psikik. Pa dyshim, kjo punë këmbëngulëse për zotërimin e plotë të drejtshkrimit nga nxënësit tanë ka nevojë të shoqërohet edhe me studime eksperimentale sociolinguistike e psikolinguistike në kushtet e vëçanta të qytetit e të fshatit. Kështu, shkolla jonë do të bëhet një vatër gjithnjë më e gjallë dhe e fuqishme, ku brezat e rinj do të mësojnë çdo ditë e më mirë t'i përdorin drejt mjetet gjuhësore dhe të zbulojnë bukuritë e pafund të gjuhës amtare.

* * *

Gjuha letrare shqipe asnjëherë nuk ka shprehur vlera kaq të mëdha kulturore sa ato që shpreh sot. Siç thotë shoku Enver Hoxha, «Shqipëria nuk është më ajo e para, — as ekonomia e saj, as kultura, as arësimi, as gjuha, as regjimi, as politika, as ideologjia»⁴⁷. Drejtshkrimi që do të miratojë ky Kongres, duke pasqyruar nivelin e kristalizimit të shqipes letrare në epokën tonë, do ta bëjë atë më të harmonishme e do ta pasurojë me një vlerë të re — me njësinë në shkrim, që përbën kurdoherë një vlerë shoqërore, sepse lehtëson kumtimin midis njerëzve dhe zhvillimin e përgjithshëm kulturor të masave.

Kjo gjuhë letrare e përpunuar dhe e njësuar, shprehje e gjallë e kulturës së popullit tonë, e dinamizmit të tij historik është fryt i shumë brezave. Ata kanë punuar me bindje të thellë se do të vinte kjo ditë dhe e ëndërronin atë. Kur u hodhën themelet e kësaj gjuhe, një nga organet kryesore të Rilindjes shkruante: «Ne parandajmë, në agimin e së nesërme, një Shqipëri të lulëzuar e intelektuale, ku do të rrojë plot gjallëri një rini e etshme për dije, e dhënë pas artit, bukurisë dhe punës. Këta shqiptarë të rinj do të gjykojnë me një drejtësi mëshirëplotë përpjekjet tona, të shartuara me dështime, ngadalësi e paafësi, por plot çiltëri të zjarrtë. Ata do të shqyrtojnë, me të gjitha mjetet e dokumentimit e të kritikës, së ç'ishte gjuha jonë e djeshme dhe ç'do të jetë gjuha e tyre e nesërme, gjuha në të cilën ata do të shprehin mendimet e tyre ose ëndrrat e tyre. Kësaj gjuhe plot muskuj,

47) Enver Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë*, Tiranë, 1968, f. 37.

ëmbëlsi e mprehtësi ata do t'i kërkojnë datën e lindjes dhe do të dinë ta përcaktojnë këtë»⁴⁸. Këtë «datëlindje» ne e njohim — është përpjekja e disa shekujve që filloi të ngrihej në një themel kombëtar nga puna vigane e rilindësve dhe e pasardhësve të tyre. Sot ne i kujtojmë ata me nderim e mirënjohje të thellë. Në këto vite, kur gjuha jonë letrare e përbashkët është bërë një realitet i gjallë dhe po hyn në një fazë të re, ne e hedhim vështrimin tonë jo vetëm prapa, por edhe përpara, tek brezat e rinj — tek ata që janë e tek ata që do të vijnë. Ne kemi besim të patundur se ata do ta zhvillojnë e do ta përsosin më tej gjuhën amtare, do ta bëjnë atë më të përpiktë, më të zhdërvjellët e më të gjerë. Gjuhën tonë letrare e pret, pa tjetër, një e ardhme më e lulëzuar.

48) Shih rev. «Albania», Viti I, N. 12. f. A-120.